# GAZETA SHQIPTARE

Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7401 E shtunë 6 Janar **2018** **Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)**

Opinioni i Ditës

Nga EDVAL ZOTO

## 8 rreziqet kryesore të 2018-ës

Në një këndvështrim optimist, viti i saponisur do të jetë vit në të cilin do të hidhen disa hapa të rëndësishëm për zhvillimin demokratik dhe politiko-ekonomik ... Vijon në faqen 20

Dje në "Europa e lirë"

Nga ARTON KONUSHEVCI

## Shfuqizimi i Speciales vë në sprovë raportet e Kosovës me shtetet mike

Raportet e Kosovës me aleatët ndërkombëtarë mund të përkeqësohen ndjeshëm në rast se institucionet vendosin të shfuqizojnë ligjin për Gjykatën ... Vijon në faqen 21

EKSKLUZIVE

Pjesa e dytë/ Intervista e akademikut kosovar

# Rexhep Qosja: Vota në OKB nuk është votë as kundër Kosovës, as SHBA-ve

Si është marrëdhënia e LSI me presidentin dhe efektet e letrës drejtuar presidentit Trump

Nga FATMIRA NIKOLLI

Në pjesën e dytë të intervistës që akademiku Rexhep Qosja ka dhënë për "Gazeta Shqiptare" merret në analizë politika e jashtme e Shqipërisë, duke marrë shkas nga vota e vendit tonë në OKB. E komentuar gjatë si votë ,,, Në faqet 8-9

TABELAT, DOKUMENTET QE NEVOJITEN PER PROCEDUREN PER BURRAT E GRATE

# ISSH: FORMULA E DALJES NE PENSION PER VITIN 2018

Instituti i Sigurimeve Shoqërore: Ndryshime dhe për vjetërsinë e punës. Ja kontributet që ju duhen për të përfituar të plotë ciklin e pensionit

*(Në foto)* Pensionistë (foto ilustruese)

Në faqen 5

FALENDERON THEMELUESIT

## Përvjetori i 'RD', Basha: Gjithçka mund të ndodhë kur mungon liria e medias

Në faqen 2

DENONCIMI I DURRSAKES

## Një prostitutë shpëton dy vajza të tjera: Si na trafikoi Nuredin Dumani

Në faqen 7

VIZITA

## Meta në Pustec: Bashkëpunim perfekt mes Shqipërisë Greqisë e Maqedonisë

Në faqen 2

FORMULARI PER PLOTESIM

## Gjermania lejon punësim studentësh, tri dokumentet e afati për të aplikuar

Në faqen 6

RREFIMI I VECANTE

## Viti i Ri pa Dritëroin, Sadija: I vështirë, nuk e prisja të ikte

Në faqen 4

BLUE TOOTH

Alesio Alia rrëfen për "GSH" eksperiencat e tij, Oriola Marashi nervozohet

# Bleona Qerreti, këngëtare në darkë miliarderësh

*Dilemat në është me Remo Ruffi-n, si përgjigjen mikeshat e saj*

Emri i saj ishte sërish në qendër të të gjitha mediave në Shqipëri edhe gjatë javës që po lëmë pas... Bleona Qereti kaloi mbrëmjen e ndërrimit të viteve në shtëpinë e multimiliarderit, pronarit të markës së famshme "Moncler" dhe kaq mjaftoi që mediat

në vendin tonë të aludonin për një histori të mundshme mes këngëtares shqiptare dhe biznesmenit të njohur. Me apo pa dashje, të gjithë e anashkaluan emrin e Fracesca Ruffini-t, bashkëshortes së Remos, 56 vjeç, baba i dy fëmijëve, të

Suplement

PERVJETORI
MEDIA

Shtrëngim duarsh dhe të qeshura në 27-vjetorin e 'RD', Patozi: S'erdha për kryetarin

# Basha: Gjithçka mund të ndodhë kur mungon liria e medias

## *Falënderon themeluesit, nuk harron Blushin*

27-vjetori i gazetës "Rilindja Demokratike"

Valentina Madani

Figura të rëndësishme politike dhe ato të me dias u bënë mbrëmë bashkë në festën e organizuar për 27-vjetorin e të themelimit të gazetës "Rilindja Demokratike". Kreu i PD-së, Lulzim Basha organizoi një pritje me njerëz të medias dhe politikës në kremtimin e 27-vjetorit të krijimit të gazetës së parë opozitare "RD". Z.Basha falënderoi themeluesit dhe gazetarët e parë, të cilët punuan për ngritjen e një gazete ndryshe nga shtypi i kohës. "Dua ta nis falënderimin me dy kryeredaktorët dhe bashkëthemeluesit, Frok Çupi dhe Mitro Çela. Po ashtu falënderoj edhe studentët gazetarë të cilët punuan vullnetarë, Blendi Fevziun, Ben Blushin, Armand Shkullakun etj.. 'RD' do të ketë përherë një vend të veçantë në historinë jo vetëm të PD-së, por edhe të Shqipërisë. 'RD' është nga të paktat media të lira. Është një ditë e reflektimit për lirinë e fjalës", theksoi z.Basha. Në ceremoni ku ishin shumë të ftuar, kryetari i PD, Lulzim Basha u shpreh se festa e "RD" është festa e fjalës së lirë, festa e të gjithëve. Basha u shpreh se gazeta "Rilindja Demokratike" do të ketë një vend të veçantë në historinë e Shqipërisë. "Për lirinë dhe kontributet, 'RD' do të ketë një vend të veçantë jo vetëm në Partinë Demokratike, por në historinë e Shqipërisë. Në këtë përvjetor përgëzoj të gjithë ata që kanë kontribuuar në këtë gazetë. Festa e 'RD' është festa e fjalës së lirë, festa e të gjithëve", u shpreh Basha. Sipas tij: "Pesha kryesore në këtë mision u takon njerëzve të medias dhe intelektualëve të fjalës. Ndaj sot dua t'u kujtoj gazetarëve dhe intelektualëve publikë fjalët e Ayn Arendt: Në çastin kur nuk kemi më lirinë e medias, gjithçka mund të ndodhë. Ajo që mundëson sundimin e çdo lloj autokracie dhe diktature është se njerëzit nuk janë të informuar. E si mund të kesh një opinion nëse nuk je i informuar? Nëse dikush gënjen vazhdimisht, pasoja nuk është se ti i beson gënjeshtrat, por se askush nuk beson më në asgjë. Ky është një nga qëllimet kryesore të regjimit të sotëm, t'i shkurajojë njerëzit, t'i bëjë pesimistë, t'i bëjë të mos besojnë në asgjë, të mos besojnë tek demokracia, të mos besojnë tek liria, të mos besojnë tek aftësia e tyre për t'u qeverisur, të mos besojnë se mund të ketë ndonjëherë politikë të mirë, sepse në mosbesim dhe dëshpërim, sundohet më lehtë. Shqiptarët kanë nevojë për të besuar tek vetja dhe tek e ardhmja. Politika ka rolin kryesor për ta ngjallur këtë besim, por roli i intelektualëve të fjalës dhe të medias është po aq i rëndësishëm. Ndaj ju uroj të gjithëve me shumë besim dhe frymëzim për një Shqipëri të lirë, demokratike dhe europiane si ajo që përshkroi RD që në ditët e para të saj", deklaroi z.Basha. Ish-deputeti i PD-së dhe ish-kryeredaktor i RD-së, z.Astrit Patozi ishte i pranishëm në festën e mbrëmshme, por pa harruar të thumbojë kreun e PD-së, Lulzim Basha. Gjatë një prononcimi për mediat Patozi tha se aty kishte ardhur për përvjetorin e "Rilindjes Demokratike" dhe jo për Lulzim Bashën. "Ditë e gëzueshme, ditë festive edhe i takon që të evitohen fjalët e hidhura, por dua të them që sot nuk kam ardhur për Lulzim Bashën, por për gazetën 'Rilindja Demokratike'. Kam ardhur me bindjen jo thjeshtë si një ish-kryeredaktor i saj, si një gazetar i saj për shumë vite me radhë, por më tepër si njëri prej njerëzve në Shqipëri që ka një koncept të qartë se çfarë është liria e medias dhe çfarë është liria e shtypit për një vend demokratik", deklaroi z.Patozi.

Kreu i PD-së Lulzim Basha

**MESAZHI**
"Politika ka rolin kryesor për ta ngjallur këtë besim, por roli i intelektualëve të fjalës dhe të medias është po aq i rëndësishëm. Ndaj ju uroj të gjithëve më shumë besim dhe frymëzim për një Shqipëri të lirë, demokratike dhe europiane si ajo që përshkroi 'Rilindja Demokratike' që në ditët e para të saj", deklaroi z.Basha.

**BESNIK MUSTAFAJ**
"Është një argument, nuk po them provë në favor të akuzave të opozitës se Edi Rama ka lidhje të drejtpërdrejt me Saimir Tahirin dhe po e merr peng reformën në drejtësi. Besoj se me këtë vendim, reforma merr një njollë", - tha Mustafaj në studion e "News 24".

**"Numri i parë u prit me padurim**

## 27-vjetori i 'RD', Berisha: Edhe sot, organ i së të vërtetës

Në 27-vjetorin e gazetës "Rilindja Demokratike", ish-kryeministri Sali Berisha përmes një statusi në 'FB' tregon se është nostalgjik për nisjen e kësaj gazete. Berisha shkruan se numrin e parë e kanë pritur me entuziazëm të gjithë. Berisha shkuan se 'RD' është edhe sot organ i së vërtetës. "Vendimi për botimin e saj ishte njëri nga vendimet më të para të Partisë Demokratike. Regjimi u përpoq, por pa sukses ta pengonte botimin e saj. Numrin e parë të saj, shumë qytetarë e pritën me padurim me një natë të bardhë, pra zbardhën natën për të siguruar një kopje të saj, e cila hapej me një editorial

të pavdekshëm të redaksisë 'E para është fjala'!", shprehet z.Berisha. Ai tregon më tej se: "Me shpejtësi të rrufeshme gazeta, si organ i të vërtetës aktuale dhe asaj të ndaluar dhe mohuar, pushtoi mendjet dhe zemrat e shqiptarëve". Sipas Berishës, "Rilindja Demokratike" vjen në këtë përvjetor si organi i lirë i shtypit të shkruar, organ i të vërtetës. "Me këtë rast le të shprehim ndërimin tone më të madh për të gjithë ata intelektuale, publicistë, gazetarë, studentë, redaktore, kryeredaktorë dhe drejtorë që themeluan gazetën e parë opozitare të vendit, që e drejtuan dhe shndërruan atë që nga numri i parë e deri në numrin e sotëm, në zëdhënëse të të vërtetave të mëdha të shoqërisë shqiptare! Gëzuar!", shprehet z.Berisha në "Facebook".

## Meta në Pustec: Bashkëpunim i shkëlqyer Shqipëri-Greqi-Maqedoni

Presidenti Meta u prit dje nga nënkryetari i Bashkisë së Pustecit, Andon Jani, përfaqësues të tjerë të pushtetit vendor si dhe nga dhjetëra banorë të minoritetit maqedonas, të cilët i uruan mirëseardhjen dhe e falënderuan për mbështetjen e përkrahjen e tij të vazhdueshme. Nënkryetari i Bashkisë së Pustecit, Andon Jani dhe kryetarja e Këshillit Bashkiak, Irena Vasilovski e falënderuan Metën për vëmendjen e treguar ndaj minoritetit maqedonas dhe e njohën me disa nga problemet që shqetësojnë banorët e zonës. Në bashkëbisedim me ta, presidenti tha: "Vëmendja ime ndaj minoritetit maqedonas do të jetë çdo ditë gjatë mandatit tim. Ne krenohemi me vlerat e minoritetit maqedonas, i cili është një pasuri për Shqipërinë. Ju garantoj se do bëj çmos dhe do mbështes të gjitha përpjekjet tuaja për ruajtjen e identitetit, traditave dhe vlerave tuaja të shkëlqyera. Duhet të bashkëpunojmë të gjithë që Bashkia e Pustecit të jetë ndër më të begatat", - theksoi Meta. Presidenti theksoi gjithashtu se, "në kuadrin e vitit të rëndësishëm mbarëkombëtar të Gjergj Kastriot Skënderbeut ramë dakord bashkë me përfaqësuesit e Bashkisë së Pustecit të vlerësojmë disa nga ngjarjet dhe personalitetet më të rëndësishme historike të kësaj zone, sikundër është edhe shkrimtari i njohur, Sterjo Spasse, biri i komunitetit maqedonas".

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokhina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu:*** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com***, **ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu:*** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**

MANDATET

## Ambasada e SHBA: Mirëpresim vendimin

Ambasada e SHBA reagoi me anë të një deklarate pas vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor për t'u hequr mandatin dy deputetëve, Aqif Rakipi nga PDIU-ja dhe Gledjon Rehovica nga LSI-ja. Ambasada thekson se ky vendim është provë që tregon se procesi i dekriminalizimit, i filluar dy vite më parë në Shqipëri vazhdon. "Ambasada e SHBA-ve mirëpret vendimin e sotëm nga KQZ për t'iu hequr mandatet Aqif Rakipit dhe Gledion Rehovicës. Ky vendim është provë pozitive se procesi i rëndësishëm i dekriminalizimit, filluar në dhjetor 2015, vazhdon në Shqipëri", thuhet në deklaratën e ambasadës së SHBA-ve në Tiranë. KQZ në mbledhjen e djeshme shqyrtoi informacionet shtesë të sjella nga Prokuroria e Përgjithshme për dy deputetët e Kuvendit, të cilët sipas organit të akuzës, kanë fshehur ndalimet në shtetin italian dhe kanë përdorur gjeneralitete të rreme".

### Votimi

Pro heqjes së mandateve të Rakipit dhe Rahovecit votuan Klement Zguri, Bledar Skënderi, Denar Biba, Vera Shtjefni dhe Edlira Jorgaqi. Gëzim Veleshnja nga LSI nuk mori pjesë ne votim, ndërsa anëtari tjetër i PD, Hysen Osmanaj nuk ishte në mbledhjen e djeshme të KQZ-së.

### Akuza

Aqif Rakipi akuzohet nga prokuroria për mbajtje të materialeve të vjedhura dhe regjistrim me emrin Skënder Ejylbegaj në 3 nëntor të vitit 1998. Kurse deputeti i LSI-së, Rehovica akuzohet për vjedhje dyqani me emrin Kusta Mina në shkurt të vitit 1999, kohë kur jetonte si student në Itali.

### Batuta

Kreu i KQZ, Klement Zguri, risolli në vëmendje shprehjen e Presidentit Ilir Meta, "me qetësi dhe dashuri". Teksa tha këtë shprehje, Zguri dha edhe një mendim të shkurtër, por që flet shumë, duke e quajtur Metën politikan të madh. "Me qetësi dhe dashuri, siç ka thënë politikani i madh, Ilir Meta", tha Zguri.

Largimi, Rakipi: Skandal i turpshëm! Rehovica: Vendim politik, e ankimoj

# Dekriminalizimi, KQZ u heq mandatet deputetëve të LSI e PDIU

## Shtyhet vendimi për Kaprin, Zguri: Po kthehet në gallatë

Valentina Madani

KQZ-ja vendosi dje t'u ndërpresë mandatet dy deputetëve Aqif Rakipit të PDIU-së dhe Gledion Rehovicës së LSI-së, pas kërkesës së bërë nga prokuroria se kanë fshehur në formularin e dekriminalizimit ndalime nga policia në Itali. Me 5 vota pro, Aqif Rakipit të PDIU dhe Gledion Rehovicës së LSI iu hoq mandatit i deputetit, pasi preken nga ligji i dekriminalizimit. Të dhënat e ardhura nga Italia, sipas prokurorisë nuk janë deklaruar nga deputetët në formularin e vetëdeklarimit. Dy deputetët nuk ishin të pranishëm në mbledhjen e KQZ-së, por u përfaqësuan përkatësisht nga avokatët Theodhori Sollaku dhe Ardian Vishaj. Mbledhja e djeshme u shoqërua me debate të forta. Në nisje të mbledhjes, avokati i deputetit Rakipi kërkoi pezullimin e procedurës së nisur nga KQZ-ja, për shkak se kishin ankimuar në Gjykatën Administrative për paligjshmëri vendimin e Kuvendit për zbatimin e ligjit të dekriminalizimit dhe tha se klienti i tij nuk preket nga ligji i dekriminalizimit edhe në rast se nuk ka deklaruar ndalimin apo mbajtjen e një emri tjetër. Edhe përfaqësuesi i deputetit Rehovica tha se kërkesa e prokurorisë ishte në shkelje të ligjit dhe e pambështetur në prova. "Mandati i deputetit ndërpritet kur ndaj tij ka dënim, të jetë dëbuar, në aktet e dosjes rezulton se deputeti Rakipi s'ka qenë asnjëherë i dënuar nga ndonjë gjykatë, s'ka pasur masë sigurimi personal, as shpallur në kërkim ndërkombëtar dhe as është dëbuar. Prokuroria ka barrën e provës të provojë shkeljen e ligjit. Shkresa e KQZ-së s'ka referencë konkrete dhe bazë ligjore. Deputeti Rakipi s'ka bërë shkelje të qëllimshme", deklaroi avokati Sollaku. Kurse avokati Visha u shpreh: "Një i tretë ka luajtur gurët në këtë mes dhe duam të dimë se kush është i treti. Rehovica nuk është deputet i inkriminuar, që do duhet të flakët jashtë Kuvendit. Keqpërdorimi institucional i pajustifikuar është i papranueshëm për ne. S'mund të pranohet kjo praktikë, si ndërpritet mandati pa asnjë provë, vetëm me një aludim si thonë letrat e prokurorit dhe pa prova?".

**REAGIMET**

Vendimi i KQZ-së për t'i hequr mandatin e deputetit u kundërshtua ashpër nga dy ish-deputetët, atij të PDIU dhe të LSI, përkatësisht Aqif Rakipi dhe Gledion Rehovica. Ata e konsiderojnë vendimin e KQZ-së si politik, të pambështetur në prova dhe aspak profesional. Ish-deputeti i LSI-së, Rehovica e cilësoi skandaloz vendimin në fjalë, të ndikuar politikisht dhe të pabazuar në ligj. Ai shprehet se do ta apelojë vendimin e KQZ-së. "Do të apeloj vendimin e KQZ-së. Ishte skandaloz si vendim, i pabazuar në ligj. Vendimi politik dhe aspak profesional", tha ai për "Raport.tv". Për vendimin reagoi edhe deputeti i PDIU-së, Aqif Rakipi, i cili e quajti atë të turpshëm. Rakipi akuzoi drejtpërdrejt Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se mori një vendim "jo transparent dhe me dyer të mbyllura". Ky reagimi u bë për "Oranews" dhe erdhi pak minuta pasi KQZ mori vendim me 5 vota për të shpallur të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të deputetit, për Gledion Rehovica dhe Aqif Rakipin. KQZ në mbledhjen e dytë me 5 vota, votoi pro kërkesës se prokurorisë për ndërprerjen e mandateve për dy deputetët. Pro heqjes së mandateve votuan Klement Zguri, Bledar Skënderi, Denar Biba, Vera Shtjefni dhe Edlira Jorgaqi. Gëzim Veleshnja nga LSI nuk mori pjesë në votim, ndërsa anëtari tjetër i PD, Hysen Osmanaj nuk ishte në mbledhjen e djeshme të KQZ-së.

**SHTYRJA**

KQZ-ja vendosi gjithashtu të kërkojë informacione shtesë edhe për kryebashkiakun e Pogradecit, Eduart Kapri, nëse është dëbuar apo jo nga Gjermania. Sipas prokurorisë, Kapri rezulton të jetë dëbuar nga Italia në vitin 1998, ndërsa vetë kryetari i bashkisë ka shënuar në formular se ka jetuar për 5 vjet edhe në Gjermani. KQZ-ja miratoi me 4 vota pro dhe 2 kundër shtyrjen e vendimit për heqjen ose jo të mandatit të Eduart Kaprit. Kjo, pasi do i kërkohet sërish informacion shtesë prokurorisë për dëbimin nga Gjermania. Kryetari Zguri tha: Po kthehet në gallatë tani... Nuk është serioze që t'i drejtohemi sërish prokurorisë për informacion. Sot është afati i fundit ligjor... Duam informacion nga Gjermania pse u dëbua", - tha anëtari i KQZ-së, Bledar Skënderi. Kurse, përfaqësuesi i PD-së, Ivi Kaso deklaroi: "Vendimin duhet ta marrë KQZ-ja, institucionet e tjera të japin informacionet, por jo t'u bëhet gjyqi. KQZ-ja nuk duhet t'i bëjë gjyqin prokurorisë".

Gjatë një mbledhjeje të KQZ-së

**Bici, në 2013 hyri në fushën e futbollit me automjet**

## Mandati i Rehovicës e Rakipit, dy deputetët e rinj në Kuvend

KQZ-ja vendosi që t'u hiqte mandatin dy deputetëve Gledion Rehovica dhe Aqif Rakipi. Tashmë në vendin e tyre do të hyjnë dy deputetë të rinj nga LSI dhe PDIU. Në vendin e Rehovicës nga lista e LSI në qarkun e Beratit do të hyjë Silva Caka, e cila ka qenë gjithashtu deputete e kësaj force politikë nga vitit nga 2013 deri në 2017. Ndërsa, për Elbasanin në vend të Rakipit do të futet Dritan Bici. Bici nuk është figurë e panjohur për mbarë opinion publik, pasi vjen nga radhët e drejtuesve në pushtetin vendor, duke qenë se ka qenë kryetar i Bashkisë së Gramshit. Mirëpo, edhe Bici rezulton se ka pasur probleme me drejtësinë. Ai rezulton i dënuar për një ngjarje të regjistruar në mars të vitit 2013, për kundërshtim të urdhrit të policisë. Bici ka hyrë me automjet në fushën e futbollit gjatë ndeshjes Gramshi-Mamurrasi dhe ka tentuar të dhunojë arbitrin e takimit. Ai është procedurar nga policia për këtë ngjarje dhe është dënuar nga Gjykata e Elbasanit me një muaj e 15 ditë burg, e konvertuar përfundimisht me 60 orë punë publike.

PERVJETORI
KUJTIMET

Rrëfimi i bashkëshortes së shkrimtarit: Një vit më parë ndenji deri në orën 01:30 në tavolinë

# Viti i Ri pa Dritëroin, Sadija: I vështirë, s'e prisja të ikte

## "Duke parë albumet, më ngacmohet kjo plagë"

Sadije dhe Dritëro Agolli

Darina Tanushi

Në shtëpinë e Dritëroit, mungesa ndihet mjaft. Një vit më parë, në 31 dhjetor të 2016, ai ka qëndruar "stoik" në tavolinën e festës deri rreth orës 01:30 të datës 1 janar 2017 dhe ka qeshur e festuar me fëmijët e bashkëshorten, Sadijen. Megjithatë, ajo ia kishte merakun prej ditësh, edhe pse nuk e besonte se shumë pak javë më pas nuk do ta kishte më pranë vetes. Ashtu si për çdo gjë, edhe këtë herë Sadija i ka qëndruar strikte traditës së vendosur nga vetë shkrimtari. Gatigati me të njëjtin shkrim dore, ajo është kujdesur që të dërgojë kartolina për miqtë e familjes së Dritëro Agollit. Ndoshta jo rastësisht ngjyrat e kartolinës kanë qenë e zezë nga jashtë dhe e bardhë brenda, por gjithsesi, rreshtat e shkruar kanë shprehur shumë mirënjohje për ata që i qëndruan pranë dhe e kujtuan shkrimtarin. "Kam qenë shumë e ngarkuar nga ana shpirtërore. Kam pasur mjaft pagjumësi këto ditë. Herën e fundit ai ndenji deri në orën një e gjysmë në tavolinë. E kisha parë shumë herë të tjera ashtu, por mendoja se do ta kalonte edhe këtë herë", shprehet bashkëshortja e Dritëroit, Sadije Agolli. E në fakt, pikëllimi i duket qartë në fytyrë. "Jo vetëm unë, por edhe fëmijët e kanë përjetuar jo mirë këtë Vit të Ri", tregon ajo. "Kam qenë e hutuar. E kam kaluar duke parë albumet. Dritëroi më ka lënë shumë kujtime dhe më ngacmohet kjo plagë sa herë i shoh", përshkruan këto ditë Sadija. Mjediset e shtëpisë e ngacmojnë vazhdimisht Sadijen, e cila ishte mësuar ta kalonte ditën me Dritëroin, duke u kujdesur për ilaçet, ushqimin, shkrimet apo leximet, për të cilat ajo gjithmonë ka qenë e para që i vinte në ndihmë. Për të mos rënë fort në sy të fëmijëve, Sadija kalon çaste në dhomën e saj, për të mbytur lotët. Por, fëmijët gjithsesi e kanë kuptuar dhimbjen e saj. "Ime më e vuan shumë plakjen e babit. Ka frikë që do ndahet nga jeta e nuk do e shohë më. Dhe vetëm trishtohet. Sot, mami nisi e vetme të shkruajë kartolinat e urimit, e mallëngjyer, e tejmbushur me kujtime, çaste të ngjashme, por askurrë vetëm. Edhe sot ajo nuk është vetëm. Gishtërinjtë i shkasin në letër pasi ajo përcjell frymën, shpirtin e babait tim, ajo përcjell edhe urimet e tij. Pasi ai ishte përveç gjeniut, njeriu i mirë Dritëro", u shpreh në fund të vitit që sapo mbyllëm, në një reagim për "Gazeta Shqiptare", vajza e Dritëroit, Elona Agolli. Familja e shkrimtarit, vajza e tij Elona veçanërisht është marrë me përgatitjen e një tjetër kujtimi të lënë nga i ati. Edhe pse ka edhe një muaj kohë nga dita kur mbushet plot një vit pa shkrimtarin, familjarët po mendojnë detajet për ceremoninë e rastit. Në këtë vit të parë do të botohet edhe një libër me letërkëmbimet e Dritëroit dhe të Sadijes në vitet 1964-1965.

Faksimile e kartolinës së shkruar nga Sadije Agolli


Faksimile e një prej krijimeve të Dritëroit, pas Vitit të Ri 2009

**PËRJETIMI**
Mjediset e shtëpisë e ngacmojnë vazhdimisht Sadijen, e cila ishte mësuar ta kalonte ditën me Dritëroin, duke u kujdesur për ilaçet, ushqimin, shkrimet apo leximet, për të cilat ajo gjithmonë ka qenë e para që i vinte në ndihmë. Për të mos rënë fort në sy të fëmijëve, Sadija kalon çaste në dhomën e saj, për të mbytur lotët.

**CEREMONIA**
Familja e shkrimtarit, vajza e tij Elona, veçanërisht është marrë me përgatitjen e një tjetër kujtimi të lënë nga i ati. Edhe pse ka edhe një muaj kohë nga dita kur mbushet plot një vit pa shkrimtarin, familjarët po mendojnë detajet për ceremoninë e rastit. Në këtë vit të parë do të botohet edhe një libër me letërkëmbimet e Dritëroit dhe të Sadijes në vitet 1964-1965.

## EURALIUS, manual me 38 formularë për drejtësinë: Ndodhet në fazë tranzitore

Misioni i Bashkimit Europian për drejtësinë, EURALIUS, ka shpërndarë një manual ku i rekomandon politikës miratimin e ndryshimeve ligjore që do të bënin efektiv Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Rekomandime ka edhe për hetimin disiplinor të gjyqtarëve dhe prokurorëve që kalojnë procesin e vetingut. Manuali përmban 38 formularë mbi rregullat që duhet të ndjekin organet e reja të drejtësisë, Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë për hetimin disiplinor të gjyqtarëve. Të tria këto organe, që në fakt ende nuk janë ngritur, udhëzohen se procedimi disiplinor nis jo vetëm me ankesë të qytetarëve, por edhe të subjekteve juridike, si për shembull një kompani. Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, si organi që ka të drejtën e hetimit disiplinor, ka të drejtë edhe të gjobisë institucionet të tjera, në rast se nuk i vënë në dispozicion dokumente plotësues në funksion të hetimit disiplinor për gjyqtarin apo prokurorin. Pas mbylljes së hetimit nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, vendimi për masën merret nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për gjyqtarët dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për prokurorët. Por, ligjet për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe ai për organet e reja të drejtësisë, është i paplotë, sepse Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar disa nene. Misioni EURALIUS i kujton politikës se këto dispozita të shfuqizuara duhet të zëvendësohen me të reja, duke marrë në konsideratë arsyetimin e Gjykatës Kushtetuese. Madje, në dokumentin e EURALIUS-it theksohet se Kuvendi duhet të ketë përparësi miratimin e ndryshimeve në ligjin për statusin e gjyqtarëve. Misioni EURALIUS e vlerëson tranzitore fazën ku gjendet aktualisht drejtësia, sepse çështja është që nëse nuk rishikohen në kohë nenet e shfuqizuara, kryesisht neni 61 dhe 159 për organet e reja të qeverisjes gjyqësore që flasin për mbledhjet plenare të KLGJ-së dhe KLP-së, atëherë dy organet më të rëndësishme të reformës në drejtësi edhe sikur të ngrihen nesër, nuk kanë bazë ligjore të plotë për të funksionuar.

**PS trajnon koordinatorët e Platformës së Bashkëqeverisjes**

## Taulant Balla: Çdo shqetësim i qytetarëve do trajtohet me seriozitet

Partia Socialiste nisi dje trajnimin e koordinatorëve të Platformës së Bashkëqeverisjes me qytetarët. Kryetari i grupit parlamentar të PS-së, njëherësh sekretar i përgjithshëm, Taulant Balla bashkë me koordinatoren kombëtare për bashkëqeverisjen, Elisa Spiropali deklaruan se "ky do të jetë mandati i bashkëqeverisjes me qytetarët", ashtu siç është thënë edhe nga kryeministri Rama. "Një platformë e vërtetë, që ka nisur të japë rezultatet e saj të para. Jo më larg sesa sot, ministrja e Drejtësisë shkarkoi disa punonjës të hipotekave pas verifikimit të ankesave të disa qytetarëve në platformën 'www.shqiperiaqeduam.al'. Kjo tregon seriozitetin dhe rëndësinë që ne u japim zërit të qytetarëve. E kemi thënë që ky do jetë mandati i bashkëqeverisjes me qytetarët dhe po e mbajmë fjalën. Këtë e theksuam edhe sot gjatë trajnimit. Prioriteti ynë është që çdo shqetësim i qytetarëve të trajtohet me seriozitetin maksimal dhe të gjendet zgjidhja ligjore", shkroi Balla në rrjetin social "Facebook".

# PENSIONET E PLEQËRISË
## NDRYSHIMET

**TABELAT/** Reforma e 2015-ës, ndryshimet për burrat dhe gratë; dokumentacioni që nevojitet

# Ja sa do të rritet mosha e daljes në pension për 2018-ën

## *Ndryshime edhe në vjetërsinë e punës, kontributet që duhen*

Voltiza Duro

Foto ilustruese

Prej 1 janarit të 2018-ës, mosha e daljes në pension për gratë do të ndryshojë sërish, duke pësuar një rritje prej dy muajsh. Kjo në kuadër të reformës së vitit 2015, ku u vendos që mosha e pensionit do të rritet çdo vit, e gratë duhet të punojnë 60 ditë më shumë për të përfituar pagesën e pensionit të pleqërisë. Respektivisht në vitin 2016, gratë dilnin në pension në moshën 60 vjeç e 4 muaj, në vitin 2017 në 60 vjeç e 6 muaj, ndërsa këtë vit, ku sërish do të aplikohet rritja, masa e pensionit për këtë kategori do të përfitohet në 60 vjeç e 8 muaj. Ndërkaq, mosha e daljes në pension për burrat është 65 vjeç e kjo nuk do të pësojë asnjë ndryshim deri në vitin 2033, ku do të fillojë të pësojë rritje me një muaj, çdo vit.

**VITET E PUNËS**

Ky ligj parashikon, gjithashtu, edhe rritjen e viteve të punës që një individ duhet të plotësojë në mënyrë që të përfitojë një pension të plotë. Nga 1 janari i këtij viti, burrave do iu duhen 36 vite e 4 muaj punë me kontribute për të marrë masën e plotë të pensionit, ku një vit më parë kjo përfitohej me 36 vite. Pra, reforma e 2015-ës, parashikon që vjetërsia e punës nga viti në vit do të pësojë një rritje prej 4 muajsh. Nga ky ndryshim preken edhe gratë ku përgjatë 2018-ës do iu duhen po 36 vite e 4 muaj për të fituar të drejtën e pensionit të plotë të pleqërisë. Kjo rritje e vjetërsisë në punë do të vazhdojë deri në vitin 2029, si për burrat ashtu edhe për gratë, ku çdo qytetar do të ketë plot 40 vite punë me kontribute. Pensionin e pleqërisë e përfitojnë të gjithë ata persona që kanë moshën dhe periudhat e sigurimit, të përcaktuara sipas ligjit. Gjithashtu, këtë masë përfitimi kanë të drejtë ta marrin edhe të gjitha ato nëna që kanë lindur 6 a më shumë fëmijë, të cilët janë mbi 8 vjeç, kanë të drejtë të dalin në pension kur mbushin moshën 55 vjeç dhe kanë 30 vjet periudhë sigurimi. Ndërkaq, pensioni mujor i pleqërisë përbëhet nga një shumë bazë dhe nga një shtesë. Shuma bazë llogaritet si raport i periudhës së sigurimit, që ka realizuar personi, me periudhën e sigurimit të kërkuar, sipas tabelave të daljes në pension pleqërie, bazuar ne moshë dhe vite sigurimi, shumëzuar me pensionin social. Shtesa do të jetë 1% për vit sigurimi shumëzuar me bazën mesatare të vlerësuar që personat e siguruar kanë arritur nëpërmjet kontributeve, gjatë gjithë historisë së tij kontributive. Ndërsa shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se pensioni social.

**PENSIONI I REDUKTUAR I PLEQËRISË**

Këtë lloj pensioni mund ta përfitojnë personat që kanë periudha sigurimi deri tre vjet para mbushjes së moshës së daljes në pension; si dhe ata që nuk kryejnë veprimtari ekonomike si të punësuar, punëdhënës, ose të vetëpunësuar. Ky pension llogaritet duke zbritur nga pensioni i pleqërisë shumën që del nga shumëzimi i numrit të muajve të përfitimit të pensionit para mbushjes së moshës, me koeficientin mujor të reduktimit. Koeficienti i reduktimit është 0.6 % në muaj. Për të përfituar pension pleqërie, pension të reduktuar dhe pension si nënë me shumë fëmijë përfituesi ose i autorizuari me prokurë paraqitet në Agjencinë Lokale të Sigurimeve Shoqërore të vendbanimit, sipas regjistrimit në gjendje civile, për të bërë kërkesën e përfitimit të pensionit të pleqërisë. Përfituesi për pension pleqërie ose i autorizuari me prokurë, së bashku me kërkesën duhet të paraqesë dhe dokumentet që vërtetojnë moshën dhe identitetin; dokumentet që vërtetojnë periudhat e sigurimit dhe llojin e punës si dhe ato që vërtetojnë të ardhurat e realizuara.

**60,8**

**VJEÇ MOSHA E DALJES NË PENSION**

Sipas reformës së vitit 2015, u vendos që mosha e pensionit do të rritet çdo vit e gratë duhet të punojnë 60 ditë më shumë për të përfituar pagesën e pensionit të pleqërisë. Respektivisht në vitin 2016, gratë dilnin në pension në moshën 60 vjeç e 4 muaj, në vitin 2017 në 60 vjeç e 6 muaj, ndërsa këtë vit, ku sërish do të aplikohet rritja, masa e pensionit për këtë kategori do të përfitohet në 60 vjeç e 8 muaj.

**36,4**

**VITE PUNE ME KONTRIBUTE**

Nga 1 janari i këtij viti, burrave do iu duhen 36 vite e 4 muaj punë me kontribute për të marrë masën e plotë të pensionit, ku një vit më parë kjo përfitohej me 36 vite. Pra, reforma e 2015-ës, parashikon që vjetërsia e punës nga viti në vit do të pësojë një rritje prej 4 muajsh. Nga ky ndryshim preken edhe gratë ku përgjatë 2018-ës do iu duhen po 36 vite e 4 muaj për të fituar të drejtën e pensionit të plotë të pleqërisë.

*Instituti i Sigurimeve Shoqërore*

**b) PËR GRATË**

| Vitet | Kategoria I | | Kategoria II | | Kategoria III | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Mosha | Vjetërsia e punës | Mosha | Vjetërsia e punës | Mosha | Vjetërsia e punës |
| 01.07.2013 - 30.06.2014 | 55 | 34 | 60v | 35 | 60v | 35 |
| 01.07.2014 - 31.12.2014 | 55v 6m | 35 | 60v | 35 | 60v | 35 |
| 01.01.2015 - 31.12.2015 | 56v | 35 | 60v 2m | 35v4m | 60v2m | 35v4m |
| 01.01.2016 - 31.12.2016 | 56v 6m | 35 | 60v4m | 35v8m | 60v4m | 35v8m |
| 01.01.2017 - 30.12.2017 | 57v | 35 | 60v6m | 36v | 60v6m | 36v |
| 01.01.2018 - 30.06.2018 | 57v 6m | 35 | 60v8m | 36v4m | 60v8m | 36v4m |
| 01.01.2019 - 31.12.2019 | 58v | 35 | 60v10m | 36v8m | 60v10 m | 36v8m |

**a) PËR BURRAT**

| Vitet | Kategoria I | | Kategoria II | | Kategoria III | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Mosha | Vjetërsia e punës | Mosha | Vjetërsia e punës | Mosha | Vjetërsia e punës |
| 01.07.2013 - 30.06.2014 | 60 | 34 | 65v | 35 | 65v | 35 |
| 01.07.2014 - 31.12.2014 | 60v 6m | 35 | 65v | 35v | 65v | 35 |
| 01.01.2015 - 31.12.2015 | 61v | 35v 4m | 65v | 35v 4m | 65v | 35v 4m |
| 01.01.2016 - 31.12.2016 | 61v 6m | 35v 8m | 65v | 35v 8m | 65v | 35v 8m |
| 01.01.2017 - 31.12.2017 | 62v | 36v | 65v | 36v | 65v | 36v |
| 01.01.2018 - 31.12.2018 | 62v 6m | 36v 4m | 65v | 36v 4m | 65v | 36v 4m |
| 01.01.2019 - 31.12.2019 | 63v | 36v 8m | 65v | 36v 8m | 65v | 36v 8m |
| 01.01.2020 - 31.12.2020 | 63v 6m | 37v | 65v | 37v | 65v | 37v |
| 01.01.2021 - 31.12.2021 | 64v | 37v 4m | 65v | 37v 4m | 65v | 37v 4m |
| 01.01.2022 - 31.12.2022 | 64v 6m | 37v 8m | 65v | 37v 8m | 65v | 37v 8m |
| 01.01.2023 - 31.12.2023 | 65v | 38v | 65v | 38v | 65v | 38v |
| 01.01.2024 - 31.12.2024 | 65v | 38v 4m | 65v | 38v 4m | 65v | 38v 4m |
| 01.01.2025 - 31.12.2025 | 65v | 38v 8m | 65v | 38v 8m | 65v | 38v 8m |
| 01.01.2026 - 31.12.2026 | 65v | 39v | 65v | 39v | 65v | 39v |
| 01.01.2027 - 31.12.2027 | 65v | 39v 4m | 65v | 39v 4m | 65v | 39v 4m |
| 01.01.2028 - 31.12.2028 | 65v | 39v 8m | 65v | 39v 8m | 65v | 39v 8m |
| 01.01.2029 - 31.12.2029 | 65v | 40v | 65v | 40v | 65v | 40v |
| 01.01.2030 - 31.12.2030 | 65v | 40v | 65v | 40v | 65v | 40v |

Dosja pranohet nga 16 deri në 26 janar në zyrat e 'DIMAK Albania' në Tiranë

# Punësim për studentët në Gjermani, tri dokumentet dhe afati për aplikim

## *Formulari që duhet të plotësojnë aplikantët*

Ornela Manjani

Studentët që duan të punojnë në Gjermani kanë një shans të ri. Qendra gjermane e informacionit për migracion, arsim profesional dhe karrierë, DIMAK, bën të ditur se ka nisur një program i ri për punësimin sezonal të studentëve shqiptarë në Gjermani. 'DIMAK Albania' informon se studentët e interesuar mund të aplikojnë nga data 16. 01. 2018 deri në datën 26.01.2018 për punësim sezonal në Gjermani.

**KUSHTET**

Kushtet e nevojshme për të marrë pjesë në punësimin sezonal janë: të jeni student i regjistruar në një universitet në Shqipëri (jo në vitin e fundit), njohuri të gjuhës gjermane (minimalisht niveli A1), të gatshëm të punojnë minimum 2 muaj dhe maksimumi 3 muaj në Gjermani gjatë pushimeve verore. Studentët aplikantë duhet të jenë të gatshëm të punojnë në sa më shumë sektorë si për shembull: turizëm, bujqësi, industri etj.

**PUNËSIMI**

Studentët shqiptarë që punësohen në këtë mënyrë si punonjës sezonalë deri në 90 ditë brenda 12 muajve nuk kanë nevojë për vizë Schengen. Formularin e aplikimit duhet ta plotësoni saktë dhe mundësisht në formë elektronike. Në faqen e dytë, në pjesën ku kërkohen njohuritë e gjuhëve, duhet të jepni një vlerësim të saktë, në mënyrë që gjatë bisedës që do të zhvilloni me rastin e kontaktimit nga kompania gjermane, të konfirmoni njohuritë e gjuhës së huaj të deklaruar. "DIMAK Albania" bën të ditur se do të pranohen vetëm aplikimet e kompletuara me dokumentet e kërkuara. Këto aplikime përcillen tek Agjencia Federale e Punës në Gjermani, e cila i përcjell ato më tej tek kompanitë gjermane, të cilat më pas do të lidhen direkt me studentët e përzgjedhur prej tyre. "DIMAK Albania" i ofron shërbimet pa pagesë dhe nuk ka kontakt me punëdhënësit, por vetëm me Agjencinë Federale të Punës. Marrëdhënia e punësimit që mund të krijohet është një marrëdhënie private punësimi. "DIMAK Albania" mund të ofrojë informacion dhe këshillim edhe gjatë këtij procesi, nëse një gjë e tillë kërkohet nga të interesuarit, si dhe në lidhje me dokumentet që duhet të kenë ata me vete, nëse përzgjidhen dhe do të udhëtojnë drejt Gjermanisë. "DIMAK Albania" (Qendra Gjermane e Informacionit për Migracion, Arsim profesional dhe Karrierë) është hapur në kuadrin e Programit global "Migracioni për Zhvillim" (PME), i financuar nga Ministria Federale gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ). PME është një program i Qendrës për Migracion dhe Zhvillim (CIM) dhe zbatohet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH dhe Shërbimet Ndërkombëtare e të Specializuara të Vendosjes (ZAV) të Agjencisë Federale gjermane të Punësimit (Bundesagentur für Arbeit, BA).

Bundesagentur für Arbeit
Agentur für Arbeit Köln

Bewerbung

Vërtetim
(Certificate of Enrolment)

Faksimile e formularit të aplikimit

Faksimile e vërtetimit

**APLIKIMET**

Këto aplikime përcillen tek Agjencia Federale e Punës në Gjermani, e cila i përcjell ato më tej tek kompanitë gjermane, të cilat më pas do të lidhen direkt me studentët e përzgjedhur prej tyre. "DIMAK Albania" nuk ka kontakt me punëdhënësit, por vetëm me Agjencinë Federale të Punës. Marrëdhënia e punësimit që mund të krijohet është një marrëdhënie private punësimi midis punëdhënësit/firmës gjermane dhe studenteve/ të përzgjedhur.

**KUSHTET**

Kushtet e nevojshme për të marrë pjesë në punësimin sezonal janë: të jeni student i regjistruar në një universitet në Shqipëri (jo në vitin e fundit). Njohuri të gjuhës gjermane (minimalisht niveli A1).
Të gatshëm të punoni minimum 2 muaj dhe maksimumi 3 muaj në Gjermani gjatë pushimeve verore. Të gatshëm të punoni në sa më shumë sektorë (turizëm, bujqësi, industri etj.).

**AFATI**

Afati i dorëzimit të aplikimeve: 16 - 26 janar 2018, ora 12:00 - 17:00. Dokumentet e aplikimit duhet të dorëzohen te "DIMAK Albania", Rruga "Skënderbej", 6/1/1. Dokumentet e nevojshme për aplikim: dy kopje të formularit të aplikimit (me fotografi), printuar para/mbrapa dhe të firmosur. Një vërtetim nga universiteti + fotokopje. Nëse është në gjuhën shqipe, e përkthyer në gjermanisht ose anglisht dhe noterizuar. Fotokopje lejes së drejtimit të automjetit.

**KUSHTET E NEVOJSHME, DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM:**

1. Të jeni student i regjistruar në një universitet në Shqipëri (jo në vitin e fundit).
2. Njohuri të gjuhës gjermane (minimalisht niveli A1).
3. Të gatshëm të punoni minimum 2 muaj dhe maksimumi 3 muaj në Gjermani gjatë pushimeve verore.
4. Të gatshëm të punoni në sa më shumë sektorë (turizëm, bujqësi, industri etj.).
5. Dy kopje të formularit të aplikimit (me fotografi), printuar para/mbrapa dhe të firmosur
6. Një vërtetim nga universiteti + fotokopje. Nëse është në gjuhën shqipe, e përkthyer në gjermanisht ose anglisht dhe noterizuar.
7. Fotokopje lejes së drejtimit të automjetit (në rast se keni të dyja anët të printuara).

**AFATI I DORËZIMIT TË APLIKIMEVE**

16 - 26 janar 2018
Ora 12:00 - 17:00
DIMAK Albania
Rruga "Skënderbej", 6/1/1

---

### Afatet për pagesën e detyrimeve tatimore

# Tatimet: Ja si të paguani me këste një detyrim tatimor të papaguar

Të gjithë tatimpaguesit, të cilët deri në datën 31.12.2017 rezultojnë me detyrime tatimore të papaguara, që përbëjnë shkak për marrjen e masave shtrënguese nga administrata tatimore dhe të cilët nga ushtrimi i aktivitetit të biznesit ndeshen përkohësisht me një situatë të keqe financiare rikujtojmë se ligji u jep të drejtën për të paguar me këste një detyrim tatimor të papaguar. Për këtë, ata duhet t'i drejtohen me shkrim drejtorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore nën juridiksion e së cilës ata janë të regjistruar dhe në këtë kërkesë duhet të shpjegohen të gjitha rrethanat dhe arsyet se përse kërkoni të lidhni një marrëveshje për të paguar me këste detyrimet tatimore. Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore, brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës, duhet të kthejë përgjigje nëse kërkesa pranohet apo refuzohet. Nëse kërkesa juaj është e paargumentuar dhe e pajustifikuar nga rrethanat, ajo mund të refuzohet ose ju mund t'ju kërkohet garanci bankare përpara se të hyni në një marrëveshje të tillë. Në rast se kërkesa aprovohet, hartohet një marrëveshje me shkrim, e cila nënshkruhet nga drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore dhe nga ana juaj. Nënshkrimi i marrëveshjes për pagesën me këste të detyrimeve tatimore të papaguara e detyron administratën tatimore që gjatë periudhës për të cilën është rënë dakord për pagesën me këste të detyrimeve tatimore të papaguara, të mos ndjekë ndaj jush masat e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore, por për përmbushjen e saj, ju keni detyrim ligjor të paguani detyrimet sipas marrëveshjes dhe detyrimet e periudhave vijuese. Nënshkrimi i një marrëveshjeje për pagesën me këste të një detyrimi tatimor nuk ndërpret llogaritjen e kamatëvonesave për mospagesë në afat të detyrimit tatimor. Marrëveshja e pagesës me këste mund të zgjidhet nga administrata tatimore në momentin më të parë që konstatohet se ju nuk e respektoni atë, lidhur me korrektësinë e pagesave si dhe kur nuk paguani detyrimet tatimore që lindin gjatë periudhës së mbuluar nga marrëveshja.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

# Vdekja e 16-vjeçarit natën e ndërrimit të viteve, gjykata lë në burg 2 nga 3 kushërinjtë Lika

16-vjeçari Klejdi Gjeta

**KURBIN** - Gjykata e Shkallës së Parë e Kurbinit ka lënë në burg dy prej tre kushërinjve Lika, të cilët qëlluan me armë zjarri në natën e ndërrimit të viteve, kur humbi jetën 16-vjeçari Klejdi Gjeta. Në fund të seancës gjyqësore, togat e zeza vendosën lënien në qeli të Alban e Ernis Likës, ndërsa u la në "arrest shtëpie", Arbër Lika. Tre të rinjtë akuzohen për veprat penale: "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit" dhe "Prishja e qetësisë publike". Ndërkohë që ende nuk është vërtetuar nëse 16-vjeçari që humbi jetën në Sanxhak është goditur nga plumbi i armës, me të cilën kanë qëlluar tre kushërinjtë Lika. Mësohet se këta të fundit kanë qëlluar me kallashnikov natën e ndërrimit të viteve në zonën e Sanxhakut në Laç dhe po në atë kohë vdiq Klejdi Gjeta. Minoreni kishte hipur në tarracën e shtëpisë për të parë fishekzjarrët, por disa minuta më pas është gjetur nga familjarët e tij, i vrarë me plumb në kokë. Sipas policisë, Gjeta kur po hidhte fishekzjarrë në tarracën e shtëpisë, është goditur nga një plumb qorr. Prokuroria ka dyshime se njëri nga plumbat që është qëlluar në ajër nga 3 të rinjtë ka goditur aksidentalisht edhe 16-vjeçarin. Të rinjtë kanë pranuar se kanë qëlluar në ajër, por nuk kanë treguar se ku e kanë fshehur armën. Në seancën e ditës së djeshme kanë qenë të pranishëm familjarët e tre kushërinjve Lika. Ata kanë reaguar për situatën e krijuar, duke akuzuar mediat dhe policinë se po tentojnë të manipulojnë publikun, pasi dy ngjarjet nuk kanë lidhje me njëratjetrën. "Po i bëni djemtë padrejtësisht kriminelë, mediat dhe policia po manipulojnë", thanë ata.

Rrëfimi i adoleshentes mbërrin te Krimet e Rënda, shpëtohen 2 vajza të tjera në Shqipëri

# Denoncimi i durrsakes në Francë, shkatërrohet rrjeti i prostitucionit

## *18-vjeçarja: Ja si më trafikoi Nuredin Dumani*

**TIRANË**

Rrëfimi i një 18-vjeçareje nga Durrësi që është shfrytëzuar si prostitutë në Francë ka zbuluar një rrjet trafikantësh, të cilët janë nën hetim në Francë, Shqipëri e Itali. Vajza me inicialet A.K., gjimnaziste në një shkollë në qytetin bregdetar, vendosi t'u shpëtojë trafikantëve duke u hedhur mbi një makinë policie në Bordo. Sipas "Top Chanel", që prej 8 muajsh vajza ka marrë në Francë statusin e viktimave që mbrohen nga shteti. Autoritetet franceze u kanë përcjellë Krimeve të Rënda rrëfimin e vajzës. Hetimi i mëtejshëm i autoriteteve shqiptare ka shpëtuar edhe dy vajza të tjera në Shqipëri, që ishin gati të trafikoheshin në të njëjtën mënyrë, por kësaj here në Itali.

Në pranga në Shqipëri ranë 3 persona, në Francë 2 persona, i akuzuari si tutor Nuredin Dumani dhe një taksist. Kurse hetimet në Shqipëri dhe Itali pritet të nxjerrin emra të tjerë të implikuarish.

Vajza nga Durrësi me inicialet A.K. u ka rrëfyer me detaje autoriteteve franceze në Bordo historinë e saj. "Isha në shkollë kur një shoqja ime më foli për Nuredin Dumanin. Ajo më tregoi se ai donte të martohej. Unë kam vazhduar komunikimin me Nuredin Dumanin përmes rrjetit social 'Facebook'. Ai më thoshte që jetonte në Belgjikë dhe se me të, jeta ime do të ndryshonte", ka treguar ajo.

Prokuroria shqiptare ka dyshime se në fakt gjatë kësaj kohe i akuzuari mbahej në një burg në Shqipëri për veprën e vjedhjes. Pas propozimit për martesë, trafikanti kishte takuar të atin e vajzës, i cili kishte refuzuar bashkimin e tyre. "Duhet të zgjedhësh o familjen, o djalin", ka dhënë ultimatumin i ati. "Unë zgjodha familjen", është shprehur vajza e trafikuar. Pikërisht në këtë moment kanë filluar edhe kërcënimet për jetën. Rezulton se Nuredin Dumani ka fotografuar motrën 3-vjeçare të adoleshentes A.K. dhe me këtë e ka kërcënuar në "Facebook".

**KËRCËNIMI**
Rezulton se Nuredin Dumani ka fotografuar motrën 3-vjeçare të adoleshentes A.K. dhe me këtë e ka kërcënuar në "Facebook". "Do ta vras motrën, po nuk u martove me mua", mësohet ta ketë kërcënuar ai. Pas një vargu kërcënimesh, vajza 18-vjeçare ka udhëtuar drejt Francës me mendimin se po martohej, por brenda javës ka përfunduar prej tij në rrugë.

"Do ta vras motrën, po nuk u martove me mua", mësohet ta ketë kërcënuar ai. Pas një vargu kërcënimesh, vajza 18-vjeçare ka udhëtuar drejt Francës me mendimin se po martohej, por brenda javës ka përfunduar prej tij në rrugë. Në dosjen e dorëzuar Shqipërisë, autoritetet franceze shprehen se në një rast vajza është arratisur prej trafikantit, por një tjetër femër pjesë e rrjetit e ka rikthyer në rrugë. Vajza mundi t'i shpëtojë rrugës vetëm më 20 mars të vitit 2017, kur ajo u hodh para makinës së policisë franceze në Bordo.

# Protestuan kundër vendosjes së flamurit turk, procedohen 60 persona

**MIRDITË** - Prokuroria e Lezhës në bazë të referimeve nga Policia e Shtetit ka nisur procedimet në gjendje të lirë për rreth 60 persona, të cilët protestuan kundër vendosjes së flamurit turk në HEC-in e Qafë-Mollës. Mësohet se 10 prej tyre, përveç akuzës për tubim të paligjshëm, akuzohen edhe për "kundërshtim të punonjësve të policisë" dhe "shkatërrim të pronës". Mesditën 31 dhjetorit në digën e hidrocentralit të Qafë-Mollës, në Fang të Mirditës disa persona grisën flamurin turk të vendosur mbi digën e hidrocentralit të ndërtuar nga kompania turke. Gjatë deklarimeve të dhëna në polici, personat e përfshirë në këtë ngjarje janë shprehur se ata nuk janë pyetur për investimin, i cili sipas tyre ka ndërruar rrjedhjen e lumit dhe se nuk duan investime turke në zonën e tyre. Dhjetëra qytetarë nëpërmjet një tubimi shkatërruan me mjete të ndryshme rrethanore simbolin e flamurit turk në HEC-in e Qafë-Mollës, ndërsa protesta u mbështet edhe nga historiani Paulin Zefi.

# POLICIA ITALIANE PUBLIKON FOTOT E 8 SHQIPTARËVE: FIKSOJENI MIRË KËTO FYTYRA...

**ITALI - Policia italiane ka publikuar fotot e 8 shqiptarëve të arrestuar pak kohë më parë, ndërsa u bën thirrje qytetarëve të fiksojnë mirë ato fytyra, pasi mund të dalin sërish nga burgu dhe të kryejnë grabitje. "Shikojini mirë këto fytyra dhe mbani mend këta hajdutë". Me këto fjalë u është drejtuar qytetarëve oficeri i policisë Oreste Liporace, komandant i karabinierëve të Padovas në Itali, raporton media italiane, "leggo.it".**

# Nëna nxjerr fëmijët në shitje, ish-burri: Esmeralda i keqtrajton, s'më le t'i takoj

**FIER** - Nëna nxjerr 2 fëmijët e saj në shitje në profilin e saj në 'FB'. Kërkon blerës dhe kërcënon se nëse nuk i shet, do t'i vrasë. Bëhet fjalë për Esmeralda Rukon nga Fieri, e cila publikoi në "Facebook" një foto me 2 fëmijët e saj ku shkruante: "Shiten fëmijët për arsye ekonomike dhe se i kam të ish-burrit, jam e divorcuar. Po nuk u shitën urgjent, do t'i vras se ma kanë sjellë në majë të hundës". Postimi i gruas që aktualisht jeton në Greqi bëri xhiron e rrjeteve dhe mediave sociale dhe shkaktoi jo pak reagime. Lajmi mbërriti edhe tek të afërmit e vajzës, në fshatin Strum të Roskovecit, të cilëve iu duket tepër e pabesueshme që një lajm i tillë të jetë i vërtetë. "S'e besoj ta bëj ajo. Mendoj se e ka bërë ai dobiçi", tha xhaxhai i Esmeraldës. Familjarët pohuan se ish-bashkëshorti e keqtrajtonte Esmeraldën e për këtë ajo u detyrua të shkonte drejt divorcit në vitin 2016. Sipas tyre, pas gjithë kësaj historie të shëmtuar qëndron ish-bashkëshorti. "Ai e rrahu. Pastaj ajo mori fëmijët dhe shkoi në një shoqatë në Tiranë. Shoqata e mbajti nja 3-4 muaj dhe i tha ik. Ajo ngeli rrugëve, sepse ai nuk i dha shtëpi", u shpreh xhaxhai i saj. Për ngjarjen reagoi edhe ish-bashkëshorti i Esmeraldës. Në një komunikim për "News 24", Ervin Dunga tha se është Emseralda, ajo që i keqtrajton fëmijët dhe jo ai. Ndër të tjera, ai fajëson ish-bashkëshorten se e ka çuar drejt depresionit, pasi nuk i lejon të takojë fëmijët që prej divorcit.

Xhaxhai i Esmeralda Ruko

INTERVISTA II

# Rexhep Qosja:

# Vota në OKB nuk është votë kundër Kosovës, as kundër SHBA

Fatmira Nikolli

*(Vijon nga numri i djeshëm)*

*"Letra e Metës për Tramp? Dëshmon se ndjenjat e padëshiruara e sundojnë politikën tonë sot!"*

*"Meta-Kryemadhi? LSI dhe presidenti një dramë politike, ndaj shqiptarët janë të ndarë në 5 shtete"*

LSI nuk më ka befasuar dhe jam i sigurt se nuk ka befasuar as shumë qytetarë të tjerë, që sadopak i përcjellin veprimet e partive politike

Në pjesën e dytë të intervistës që akademiku Rexhep Qosja ka dhënë për "Gazeta Shqiptare" merret në analizë politika e jashtme e Shqipërisë, duke marrë shkas nga vota e vendit tonë në OKB. E komentuar gjatë si votë kundër Kosovës e kundër SHBA-ve, e mbi të gjitha si votë që sjell pasoja negative për vendin në arenën ndërkombëtare, profesori thotë se nuk duhet parë asisoj. "Në asnjë mënyrë, sipas mendjes sime nuk mund të shihet si votë kundër Amerikës. Nuk mund të shihet ajo as si votë kundër presidentit Donald Tramp. Nuk mund të shihet ajo as si votë kundër Kosovës. Jo, jo, jo", nënvizoi, duke gjetur vend për kritika sa i takon letrës që presidenti Ilir Meta i dërgoi presidentit të SHBA-ve, Donald Trump. Në letrën në fjalë, ai thoshte se vota e qeverisë nuk përfaqësonte shqiptarët.

Një ndalesë e gjatë bëhet në këtë intervistë edhe në raportin publik të presidentit Ilir Meta dhe bashkëshortes së tij, Monika Kryemadhi si kryetare e një partie opozitare. "Si po ia del kjo parti e bashkëshortes së kryetarit të Shqipërisë, në thelb e kryetarit të Shqipërisë, të jetë edhe në krye të Shqipërisë, edhe në opozitë, madje në një opozitë shumë egër? Përgjigjet në këto pyetje mund të jenë të ndryshme, por të gjitha këto përgjigje e lejojnë një përfundim: në jetën politike shqiptare sot po ndodh një dramë politike, që nuk mund të ndodhë në asnjë vend demokratik në botë. Po e lejojnë qytetarët e Shqipërisë!", thotë ai.

Nga ana tjetër, duke refuzuar të komentojë lëvizjet e Spartak Brahos nga krah i djathtë i Metës në krah të djathtë të Ramës, ai i jep një shuplakë të fortë vetë lëvizjeve të LSI, nga aleat i së djathtës në aleat të së majtës e tanimë aleat i së djathtës.

Në fund e jo për nga rëndësia, ndalemi në Kosovë, ku flitet për kryeministrin e sotëm të Kosovës, Ramush Haradinaj, "për rrogën e tij të dyfishuar si kryeministër, për të ardhurat e tij të shumta mujore, e vjetore, për shumëfishimin e zëvendëskryeministrave, të zëvendësministrave, të këshilltarëve e të privilegjeve të tjera të tij e të ministrave të tij po shkruajnë boll, shumë e shumë të tjerë".

**- Profesor, një votë kundër "Jerusalemit" kryeqytet ka ngjallur një valë debati në Tiranë. Një palë e lexojnë si votë kundër Amerikës, një palë si votë kundër Trampit, një palë si votë kundër Kosovës, por edhe si një votë në union me Evropën. Ju, profesor, si e lexoni këtë?**

- Në asnjë mënyrë sipas mendjes sime nuk mund të shihet si votë kundër Amerikës. Nuk mund të shihet ajo as si votë kundër presidentit Donald Tramp. Nuk mund të shihet ajo as si votë kundër Kosovës. Jo, jo, jo.

SHBA-të janë shteti ndaj të cilit kanë pasur, kanë e do të kenë shqiptarët, gjithë shqiptarët, mendime dhe ndjenja të jashtëzakonshme, të veçanta përkushtimi. Pas luftës çlirimtare në Kosovë, SHBA-të janë shteti ndaj të cilit ne kemi përkushtim mirënjohës historik.

Vota kundër "Jerusalemit" kryeqytet është votë në pajtim me votën e shteteve të Bashkimit Evropian, pjesëtare e të cilit Shqipëria dëshiron të bëhet dhe të shpresojmë, do të bëhet pa shumë, shumë vonesë e të Britanisë së Madhe – aleates së gjithmonshme më të përkushtuar të SHBA-ve.

Për të gjitha arsyet e sipërthëna, letra e kryetarit të Shqipërisë, Ilir Meta, dërguar kryetarit amerikan, Donald Tramp, për votën e Shqipërisë në OKB mund të vlerësohet si hap politik e diplomatik që dëshmon se sa ndjenjat e padëshiruara e sundojnë politikën tonë sot!

**- A mendoni se kjo votë do të sjellë probleme në politikën ndërkombëtare ndaj Shqipërisë e shqiptarëve?**

- Mendoj se kjo votë nuk do të sjellë kurrfarë problemi në politikën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ndaj Shqipërisë a Kosovës e shqiptarëve kudo qofshin ata. SHBA-të janë shtet i madh, fuqi e parë botërore, e cila politikën e vet ndërkombëtare nuk e ndërton në bazë të një votimi në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. SHBA-të janë fuqi e parë botërore, e cila politikën e saj ndaj një shteti e populli e ndërton duke pasur parasysh shumë të dhëna, shumë faktorë, shumë kohë, shumë traditë e shumë marrëdhënie me atë shtet e me atë popull. Për të gjitha këto arsye, më duket naive të besohet se vota e Shqipërisë në OKB në lidhje me Jerusalemin mund të sjellë farë problemi në politikën amerikane ndaj Shqipërisë e shqiptarëve.

**- Ju ishit një ndër ata që keni përshëndetur koalicionin PS-LSI, që solli dy partitë e majta në pushtet. Pas një mandati, ata janë ndarë, secili në "llogoren" e vet kundër ish-partnerëve. Si e shihni ju këtë ndryshim?**

- Këtë ndryshim e shoh i pabefasuar.

**- Pse thoni kështu: i pabefasuar?**

- Them se me këtë ndryshim, LSI nuk më ka befasuar dhe jam i sigurt se nuk ka befasuar as shumë qytetarë të tjerë, që sadopak i përcjellin veprimet e partive politike, për arsye se ajo, LSI-ja, është parti që në vazhdimësi, prej themelimit, hidhet prej një ane në anën tjetër, prej anës së majtë në anën e djathtë, prej anës së djathtë në anën e majtë. Duke u hedhur kështu prej të majtës në të djathtë dhe anasjelltas prej të djathtës në të majtë LSI përpiqet të arrijë në pushtet, të bëhet pushtetmbajtëse. Dhe, e tillë është bërë dhe vazhdon të bëhet. E la të majtën dhe hyri në koalicion qeveritar me të djathtën: me PD-në e Sali Berishës. Para afër pesë vjetësh e la PD-në e Sali Berishës dhe hyri në koalicion qeveritar me të majtën e Edi Ramës. Tani, kur Ilir Meta, në sajë të kërcimeve të këtilla prej të majtës në të djathtë e prej të djathtës në të majtë arriti të bëhet kryetar i Shqipërisë, Partia e tij, LSI, e quajti të arsyeshme të hidhet në të djathtën me PD-në e Lulzim Bashës në të vërtetë të Sali Berishës. Dhe, kështu Ilir Meta arriti të bëhet kryetari i parë i Shqipërisë, që do të mbajë dy shalqinj në të njëjtën dorë: shalqirin e së majtës dhe shalqirin e së djathtës.

Në foto: Presidenti Ilir Meta

"Si po ia del kjo parti e bashkëshortes së kryetarit të Shqipërisë, në thelb e kryetarit të Shqipërisë, të jetë edhe në krye të Shqipërisë, edhe në opozitë, madje në një opozitë shumë egër?"

**Pse sillet kështu, pse vepron kështu LSI? Për të mirën e përgjithshme apo për të mirën vetjake?**

Nuk ka dyshim se LSI vepron kështu, hidhet kështu prej anës së majtë në anën e djathtë dhe anasjelltas duke mos pasur parasysh se ashtu nuk mund t'i shërbehet të përgjithshmes. Mund të thuhet kështu për arsye se kërcimet e këtilla prej të majtës në të djathtë e prej të djathtës në të majtë e bëjnë të pamundshme politikën që duhet të ketë parime, standarde, vlera demokratike. Mund të thuhet kështu për arsye se me kërcimet e këtilla prej një ane në anën tjetër partiake, politike, pushtetore cenohen vlerat që përbëjnë identitete të qëndrueshme politike, shtetërore dhe, më në fund, demokratike!

**- Kemi një LSI, që ka ish-kryetarin president dhe bashkëshorten e tij kryetare. Si po ia del të jetë ajo edhe në opozitë edhe në pushtet?**

- Çdo qytetar i Shqipërisë dhe çdo shqiptar do të duhej të vetëpyetej: vërtet si po ia del LSI të jetë edhe në krye të shtetit edhe në opozitë, madje në një opozitë shumë të egër ndaj pushtetit të vet, ndaj qeverisë në të cilën ishte edhe ajo vetë!

Si po ia del kjo parti e bashkëshortes së kryetarit të Shqipërisë, në thelb e kryetarit të Shqipërisë, të jetë edhe në krye të Shqipërisë, edhe në opozitë, madje në një opozitë shumë egër? Përgjigjet në këto pyetje mund të jenë të ndryshme, por të gjitha këto përgjigje e lejojnë një përfundim: në jetën politike shqiptare sot po ndodh një dramë politike që nuk mund të ndodhë në asnjë vend demokratik në botë. Po e lejojnë qytetarët e Shqipërisë! Po e lejojnë intelektualët e sotëm shqiptarë? Po e lejojnë shqiptarët kudo qofshin ata sot!

Po nuk është kjo drama e vetme, as drama e parë politike shqiptare. Për shkak se në jetën politike, madje, në jetën kombëtare shqiptare kanë ndodhur gjatë së paku qe dy shekuj, ➔


Në foto: Akademiku Rexhep Qosja

**KOSOVA**
Ramush Haradinaj, për rrogën e tij të dyfishuar si kryeministër, për të ardhurat e tij të shumta mujore, e vjetore, për shumëfishimin e zëvendëskryeministrave, të zëvendësministrave, të këshilltarëve e të privilegjeve të tjera të tij e të ministrave të tij po shkruajnë boll, shumë e shumë të tjerë...

**SHQIPTARËT, TË MJERËT E VIKTOR HYGOSË**
Mjerisht edhe në Shqipëri dhe në Kosovë janë pranuar dhe janë zbatuar pa kurrfarë konsideratash ndaj gjykimeve kritike, mësimet teorike dhe praktike të neoliberalizmit e të korporativizmit global. Pasoja e kësaj është gjendja sociale që kemi: e kemi në njërën anë klasën e të pasurve, klasën e njerëzve politikë të pasuruar shpejt e lehtë e paligjshëm shumë më tepër se ligjshëm dhe të heronjve të rinj të medieve, kurse në anën tjetër klasën e të varfërve, të të shpërfillurve, të të mjerëve të Viktor Hygosë.

← përpos të tjerash, edhe drama të ngjashme politike e çpolitike, shqiptarët kanë mbërritur në shekullin 21 ashtu siç kanë mbërritur: të copëtuar në pesë shtete të Ballkanit, të copëtuar në pesë shtete të Ballkanit si populli më i varfër në Evropë, i cili priste të ishte i arnuar sadopak territorialisht prej të tjerëve dhe i cili priste e po pret edhe sot të ndihmohet materialisht, ekonomikisht, mendërisht prej të tjerëve, në radhë të parë prej Evropës dhe prej Amerikës. Dhe, kështu me radhë e pa radhë!

**- Spartak Braho ose "Baba Taku", një ndër njerëzit më të afërt të Metës është tanimë një ndër njerëzit përkrah Ramës. Ç'është sipas jush kjo lëvizje: meritë e Ramës për të mbledhur rreth vetes ata që i duhen, paaftësi e LSI-së për të mbajtur pranë vetes ata që i duhen apo një njeri i LSI-së në gjirin e PS-së?**

- Nuk dua të harxhoj fjalë për një akrobacion të këtillë individual.

**- Bashkëpunimi Shqipëri-Kosovë, përveç mbledhjeve të përbashkëta të qeverive që shfaqen drejtpërdrejt në mediet e dy shteteve, a ka mundur të japë rezultat në ekonomi, kulturë...? Flasim për bashkim kombëtar, por para se të mbërrijmë aty, ç'duhet bërë për atë që ju e quani bashkim i shqiptarëve?**

Përvoja historike ka dëshmuar se popujt e ndarë dhunshëm, siç ishin dhe vazhdojnë të jenë të ndarë shqiptarët, më parë janë bashkuar në kulturë, në arte, në shkencë e mandej edhe në ekonomi e politikë. Mbledhjet e përbashkëta të dy qeverive tona pa dyshim janë të vlefshme qoftë edhe me simbolikën e tyre. Por, shumë më e rëndësishme është, që mbledhjet e tyre të përbashkëta, që herën e fundit u kurorëzuan me një varg marrëveshjesh të nënshkruara prej dy kryeministrave, të mos mbesin të vlefshme vetëm me simbolikën e tyre, po të sjellin bashkëpunim institucional, kulturor, ekonomik, shkencor, bashkëpunim institucional në fusha të ndryshme të jetës sonë.

**- Të ndarë në shumëçka, shqiptarët duket se janë të bashkuar vetëm në dhembje e skamje.**

Në foto: Ilir Meta, Linda Rama, Monika Kryemadhi, Edi Rama gjatë koalicionit PS-LSI

**Valë të ikjeve ka në Kosovë e valë të ikjeve ka në Shqipëri. Me gjithë vitet e lirisë a demokracisë, varfëria duket se është ulur këmbëkryq në të dy anët e kufirit. Cilat janë politikat sociale që duhet ndjekur?**

- Mjerisht edhe në Shqipëri dhe në Kosovë janë pranuar dhe janë zbatuar pa kurrfarë konsideratash ndaj gjykimeve kritike, mësimet teorike dhe praktike të neoliberalizmit e të korporativizmit global. Pasoja e kësaj është gjendja sociale që kemi: e kemi në njërën anë klasën e të pasurve, klasën e njerëzve politikë të pasuruar shpejt e lehtë e paligjshëm shumë më tepër se ligjshëm dhe të heronjve të rinj të medieve, kurse në anën tjetër klasën e të varfërve, të të shpërfillurve, të të mjerëve të Viktor Hygos. Një ndarje e tillë, një largesë aq e madhe mes dy klasave edhe në vijën historike sjell vetëm atë që e kishte sjellë aq shpesh gjatë historisë: sjell revolucion. Para pak ditësh mësova se çfarë masash propozonte një intelektual i sotëm evropian për të zbutur, për të përmirësuar gjendjen e të varfërve në vendet ku ka shumë të tillë. Ai propozonte sistemin e të ashtuquajturit banim social, domethënë të banesave të lira për klasën punëtore, sistemin e ndihmës për familjet me shumë fëmijë, mbrojtjen e sipërmarrjeve të vogla e të mesme, që ulin papunësinë, thoshte ai, e unë do të shtoja edhe sistemin e mbrojtjes shëndetësore falas.

Sociologë e politikologë perëndimorë po shkruajnë se për shkak të pasurimit gjithnjë e më të madh të të pasurve dhe varfërimit gjithnjë më të paduruar të të varfërve, një numër i shteteve sot edhe po u afrohen ndryshimeve që quhen revolucion. Ashtu qoftë.

**- Kosova ka kaluar dy palë zgjedhje, ku balancat politike kanë ndryshuar. A kanë mundur politikanët në Prishtinë të jenë liderë e udhëheqës dhe si e shihni Haradinajn kryeministër?**

- Për kryeministrin e sotëm të Kosovës, Ramush Haradinaj, për rrogën e tij të dyfishuar si kryeministër, për të ardhurat e tij të shumta mujore, e vjetore, për shumëfishimin e zëvendëskryeministrave, të zëvendësministrave, të këshilltarëve e të privilegjeve të tjera të tij e të ministrave të tij po shkruajnë boll, shumë e shumë të tjerë.

Në qoftë se duam të ndihmojmë Kosovën shtet që të lirohet prej të këqijave që e kanë pllakosur nuk duhet të merremi, siç po ndodh tani, vetëm me kryeministrin e sotëm.

Ramush Haradinaj u bë kryeministër i Kosovës në një kohë kur në Republikën e Kosovës janë mbledhur shumë të këqija e shumë dëshpërime. E, ç'është e vërteta, ai shpejt i shtoi edhe vetë disa të këqija të reja e shumë dëshpërime.

Po i them disa prej këtyre të këqijave që u prodhuan prej oligarkëve tonë politikë.

Institucioneve të Kosovës sot u është rrëmbyer politika.

Në institucionet e Kosovës janë përmbysur drejtësia, e vërteta dhe etika.

Dhe, s'ka nevojë t'i emërtoj unë rrëmbyesit e përmbysësit: i shihni ditë e natë duke u kapardisur në televizionet që u shërbejnë përtokas atyre. I pamë edhe natën e Vitit të Ri mbas orës 20:00 në "Klan Kosova". Dhe i pamë duke u larë e duke u lyer me plot gënjeshtra politika e tyre e sotme!

> Pse sillet kështu, pse vepron kështu LSI? Për të mirën e përgjithshme apo për të mirën vetjake? Nuk ka dyshim se LSI vepron kështu, hidhet kështu prej anës së majtë në anën e djathtë dhe anasjelltas duke mos pasur parasysh se ashtu nuk mund t'i shërbehet të përgjithshmes.

Institucionet politike e shtetërore të Kosovës janë të zhytura në korrupsion, që BE-ja e quan pandemik dhe në nepotizëm po ashtu pandemik!

Dhe, prodhimi i parë korruptiv i këtyre institucioneve janë pasanikët e pasuruar duke qenë në pozita të larta, të mesme e kur e kur të ulëta politike e administrative!

Në Kosovë sot është bërë mosekzistuese fryti shoqëror shumë i rëndësishëm i Renesancës evropiane – shtresa e mesme!

Në Kosovën e sotme shpërfillen siç nuk ka ndodhur kurrë më parë në historinë shqiptare intelektualët dhe të gjithë krijuesit e arteve përpos prodhuesve të pornografisë politike dhe mediale!

Në Kosovë sot është e përçmuar, e shtypur, e skllavëruar si kurrë më parë klasa punëtore!

Në Kosovë, në të vërtetë për Kosovën sot nënshkruhen marrëveshje që cenojnë tërësinë tokësore dhe sovranitetin e saj pa pasur këshilltarë dhe pa e konsultuar Kuvendin nënshkruesit e tyre!

Në Kosovë, në të vërtetë për Kosovën sot nënshkruhen marrëveshje që cenojnë tërësinë tokësore dhe sovranitetin e saj, që u imponohen deputetëve prej nënshkruesve, që pas një a dy vjetësh shpallen kurthe të BE-së po prej nënshkruesve, por që pas qortimeve prej përfaqësuesve evropianë prapë shpallen të rëndësishme po prej atyre nënshkruesve!

Në Kosovë sot, si në disa sisteme të përparme famëkëqija, kërkohen me qirinj armiqtë politikë e shtetërorë!

Në Kosovë sot gjykatësit e kapur politikisht dhe policia janë gjithnjë e më të gjithëfuqishme.

Burgjet e Kosovës sot ndodh të jenë të "stolisura" edhe me të burgosur politikë!

Në Kosovën e sotme ndodhin edhe veprime e sjellje komike, qesharakëzuese! Dhe, ndër këto veprime e sjellje komike qesharakëzuese hynë edhe emërtimet e 22 vjeçeve si këshilltare politike, zgjedhja e gjashtë zëvendësministrave të një ministreje, uzurpimet e shpeshta të rolit të kryeministrit e të kryetarit të Kuvendit prej presidentit, shpallja e diplomatëve dhe dërgimi i tyre në ambasada qoftë edhe në vende me tradita diplomatike të njerëzve, siç dëgjova një ditë, të sjellë "prej malit"!

E të tjera. E të tjera.

Analistëve, gazetarëve, pjesëtarëve të organizatave joqeveritare, që kohë pas kohe po shkruajnë për gjendjen politike, shoqërore, shtetërore të Kosovës sot, do t'u thosha të kërkojnë shkrimin e politikologut Lorens Brit me titullin *Katërmbëdhjetë karakteristikat e fashizmit*, të botuar në revistën *Hulumtime falas*. Me keqardhje po u them se në të do të mësojmë shumëçka edhe për veçoritë e pushtetit tonë. Mjerisht.

Prej se Kosova është bërë shtet i lirë e më vete, më 17 shkurt 2008, kemi pasur disa kryetar e kryetare të shtetit, disa kryetar të Kuvendit dhe disa kryeministra. Por, shtetar, por prijës, nuk kemi pasur. Po thuaj të gjithë ata që janë ndërruar me zgjedhje kanë shikuar, si po thonë e po shkruajnë edhe zëdhënës të tyre të djeshëm, kanë shikuar pra si të pasurohen vetë dhe si t'i pasurojnë të vetët! Dhe, ashtu në pikëpamje materiale, ekonomike, financiare kanë siguruar jetën e pasardhësve të vet e të të vetëve të tjerë për shumë kohë të ardhshme. Por ashtu, njëkohësisht, i kanë siguruar vetes edhe kujtim të keq, edhe histori të shëmtuar. Do të kujtohet prandaj për të mirë roli në luftë i atyre që ishin në luftën e UÇK-së, por do të kujtohet për të keq roli i disave prej tyre në paqe!

***(*Titujt dhe detajet janë të redaksisë. Vijon nesër)***

Qëllohet me 5 plumba Korab Peposhi. Policia: Pista e hetimit, hakmarrja

# Plagoset rëndë 40-vjeçari në Tiranë, ja historia e tij

## *Shpallet në kërkim autori Fredi Rrushi*

Ina Allkanjari

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur mesditën e djeshme në afërsi të urës së Institutit Bujqësor, në kryeqytet, ku si pasojë ka mbetur i plagosur 40-vjeçari Korab Peposhi. Burime pranë forcave policore bëjnë me dije se shtetasi Fredi Rrushi dyshohet të jetë personi, i cili ka qëlluar me 5 plumba 40-vjeçarin. Shkak i konfliktit dyshohet të ketë qenë një debat i momentit, çka ka përfunduar me përdorimin e armëve. Dyshohet se në konflikt morën pjesë disa persona, për vetëm njëri mbeti i plagosur me armë zjarri. Policia ka ngritur pikat e kontrollit për kapjen e autorëve të ngjarjes, teksa u sekuestruan edhe kamerat e sigurisë së zonës. Një tjetër pistë që policia po heton është ajo e hakmarrjes, pasi viktima dhe autori njiheshin më parë. Sakaq mësohet se i plagosuri është dërguar në spital dhe ndodhet nën kujdesin e mjekëve. Nga ana tjetër, forca të shumta të "Shqiponjave" janë vënë në ndjekje të autorit dhe po punohet për arrestimin e tij.

Vendi ku ndodhi ngjarja

### AUTORI I PLAGOSJES

Autori i plagosjes së 40-vjeçarit Peposhi, Fredi Rrushi nuk është një emër i panjohur për policinë, pasi rezulton person me precedent penal. Mësohet se Rrushi ka qenë i dënuar më parë për një plagosje të ndodhur në Kamzë dy vite e ca më parë. Ndërkohë, edhe i plagosuri, Korab Peposhi është person me precedent penal, pasi në gusht të 2011 është arrestuar në Itali për kokainë. Ngjarja e rëndë ku u përfshi Rrushi u regjistrua tre ditë para Vitit të Ri, në 28 dhjetor 2015, në vendin e quajtur bulevardi "Blu", pranë vilës nr. 23 Kamzë. Për këtë ngjarje u dënua me 10 vite burg i riu Amarild Dushku, pasi plagosi rëndë, shtetasit Klevis Halili dhe Jurges Mullaj dhe 5 vite burg shokut të tij, Fredi Rrushi. Amarild Dushku dhe Fredi Rrushi pas një debati për hedhjen e fishekzjarrëve janë konfliktuar fizikisht me të dëmtuarit Klevis Halili dhe Jurges Mullaj. Më pas pranë dy viktimave u afrua një mjeti tipit "Benz" me targa gjermane DO 107 C, i drejtuar nga i pandehuri Amarild Dushku, ndërsa brenda ishte dhe Fredi Rrushi, ndërsa është qëlluar me breshëri nga brenda me një armë zjarri ndaj Klevis Halilit dhe Jurges Mullajt. Në atë kohë u raportua se shkaku i konfliktit ka qenë fakti se Jurges Mullaji kishte hedhur një fishekzjarr në afërsi të një bilardoje ku ndodhej Amarild Dushku. Kaq ka mjaftuar që mes tyre të nisë një sherr që degjeneroi deri në përdorimin e armës.

## Nuk fituan certifikatën e sigurisë, 60 oficerë të policisë s'mund të vijojnë karrierën në nivele të larta

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe strukturat përkatëse në Policinë e Shtetit kanë refuzuar certifikatat e sigurisë për 60 efektivë të policisë së shtetit me grada të niveleve zbatuese, të mesme dhe të larta. Arsyet e refuzimit mësohet të kenë qenë incidentet që ata mund të kenë pasur në radhët e policisë, probleme të vërejtura gjatë hetimit të dosjeve të ndryshme, vërejtje të dhëna nga eprorët e deri te probleme të mundshme me deklarimin e pasurisë. Certifikata e sigurisë është e nevojshme për ata oficerë që duhet të kenë akses për informacione të rëndësishme që kanë të bëjnë me krimin e organizuar, antiterrorin dhe krimet e rënda. Gjithashtu, pajisja me certifikatë sigurie është një element i rëndësishëm në përcaktimin e karrierës së shumë prej efektivëve që duhet të vijojnë karrierën në nivele të larta. Ende nuk janë identifikuar emrat e personave apo funksionarëve që iu është refuzuar certifikimi i sigurisë, por shumë shpejt ata pritet të lënë detyrat e rëndësishme që mbajnë nëse kanë të bëjnë me informacione sekrete të rëndësishme. Mësohet se oficerët nuk do të përjashtohen nga policia, por pritet të emërohen në strukturat e rendit, apo struktura në të cilat nuk është e nevojshme pajisja me certifikatë sigurie. Sakaq pritet që shumë shpejt të gjithë efektivët dhe drejtuesit e policisë t'i nënshtrohen edhe vetingut.


bashkëpunimi gjerman DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT Implemented by giz

*Programme "Social Rights for Vulnerable Groups" and programme "Sustainable Regional and Eco-nomic Development, Employment Promotion and VET"*

The *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit* GmbH (GIZ) is a federal enterprise that supports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation for sustainable development.

*Programme: "Social Rights for Vulnerable Groups"*

The aim of the regional programme "Social Rights for Vulnerable Groups" (SoRi) is to improve the conditions for se-curing equal social rights to vulnerable groups in selected municipalities. Primarily state institutions, which are the enti-ties obliged to guarantee human rights and social services, but also NGOs which provide services are at the focus of the human rights approach. Their capacities (both employees' individual capacities and the organisational capacities of state institutions) should be strengthened with this programme.

*Programme: "Sustainable Regional and Economic Development, Employment Promotion and VET"*

The objective of the new programme reads: "The employment situation for employees and self-employed, especially qualified young people, is improved." The programme will follow a nation-wide approach. It has four fields of activity: (i) Vocational Education and Training, (ii) MSME Promotion, (iii) Social Initiatives and (iv) Investment Promotion & Pol-icies and Strategies for Employment Promotion.

GIZ Office Albania seeks the following staff: Office Manager/ Administrative Assistant

The Office Manager will work for two GIZ programmes.

A. Responsibilities

The office manager is responsible for:

■ under the supervision of the National Coordinator/Programme Team Leader ensures that all administrative tasks of the programme are fulfilled timely and in a competent professional manner;
■ daily secretarial chores of the SoRi-programme;
■ ensure all needed organizations are made for different events, meeting, trainings, workshops as seminars, as planned in the programme, according to GIZ rules and regulations;
■ ensure regular communication and flow of information within the programme office in Albania, with GIZ CO - especially with SoRI Kosovo office but also with other GIZ SoRi offices dealing with the programme (Macedo-nia, BiH, Serbia), with other GIZ programmes in the two countries relevant for the fields of intervention of SoRi;
■ ensure that good flow of information and coordination is maintained with all local, central and international partners of GIZ SoRi;
■ filing documents in reference files and/ or in DMS in line with GIZ's filing rules;
■ assisting the National Coordinator and the National Advisor for Albania and other members of the team in their administrative tasks, as needed;
■ ensure that financial and administrative tasks are fulfilled in compliance with GIZ rules and regulations;
■ quality check of the financial reports for Local Subsidies;
■ supports ProSEED financial expert in preparing Job Cards;

The office manager performs the following tasks:

B. Tasks

1. Secretarial Work and Services

■ manages incoming and outgoing correspondence;
■ answers, screens, forwards and/or returns phone calls and messages;
■ maintains the calendar of programme deadlines and events;
■ supports organising administrative and logistical aspects of programme activities;
■ prepares and organises internal and working meetings and takes minutes;
■ organises the travelling and accommodation of programme staff and of incoming international experts;
■ ensures meeting of visibility criteria of GIZ;
■ organises study tours abroad;
■ ensures guests' and experts' comfort;
■ organizes translations of documents and/or interpretation;

2. Administration

■ coordinates with the GIZ office on the mode of service delivery;
■ files the documents in reference files and in DMS in line with GIZ's filing rules;
■ edits and files reports and programme documents;
■ ensures that computers and software function properly;
■ supports procurement processes in accordance with guidelines;
■ supports the implementation of audit and/ or monitoring missions;

3. Finance and Accounting (SoRi programme)

■ manages the Cash Box of the programme;
■ helps monitoring expenses in accordance with the budget;
■ prepares invoices and receipts for accounting and executes payments and checks for compliance with GIZ rules;
■ supervises costs and expenditures of the programme budget and helps preparing the financial report of the programme;

C. Required qualifications, competences and experience

Qualifications

■ University degree in relevant qualification Finance and/or Business; Management/Administration equivalent of BA or MSc;
■At least 2 years of professional experience, preferably in a comparable position;
■ Good working knowledge of ITC technologies (related software, phone, fax, email, the internet) and computer applications (e.g. MS Office)
■ Very good knowledge of English, ideally a knowledge of German;
■ In-depth understanding of financial planning and accounting;
■ Customer and service-oriented attitude;
■ Excellent communication and organisational skills;
■ Willingness to work in a team;
■ Willingness to up skill as required by the tasks to be performed;

Contract conditions:

■ 80%-100% employment
■ Programme office in Tirana
■ Assignment period: until 31.12.2019

Please forward your application until 15th of January 2018, to GIZ Office Albania by E-Mail: giz-albanien-hr@giz.de including the following information: Application letter, CV in English (Euro Pass format), references. Only short-listed candidates will be contacted for interviews. They might be asked to bring certified copies of their diplo-mas and work certificates. *GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimina-tion!*



bashkëpunimi gjerman DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT Implemented by giz

Global Programme Migration for Development

The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) is a federal enterprise that sup-ports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation for sustainable development. The Global Programme „Programme Migration for Development" is commissioned by the Ger-man Federal Ministry for Economic Cooperation and Development (BMZ) and is being implemented under the umbrella of the Centre for Migration and Development (CIM) – a joint operation of the Deutsche Gesell-schaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) and the International Placement Services (ZAV) of the Federal Employment Agency.

The overarching objective of the programme is to strengthen the development-relevant contributions of mi-grants in their countries of origin and improve the framework conditions for legal migration in selected partner countries. This objective is actively being pursued within five fields of activity:

(1) Migration Policy Advice: the policy frameworks for legal migration and the developmental contributions of migration are being improved through structured policy advice in the area of voluntary and forced migration;
(2) Migration Advice: access to information about legal ways of migration for potential migrants is being enhanced through migration advice;
(3) Development-oriented Return of Migrants: Returning migrants are contributing to home country devel-opment through knowledge transfer;
(4) Diaspora Cooperation: the developmental impact of the diaspora is being strengthened through diaspora cooperation;
(5) Business Ideas for Development: migrants receive effective counseling and are being qualified to imple-ment business ideas in their countries of origin.

GIZ Office Albania seeks the following staff: Junior Advisor/Finance

Tasks:

Advice and Monitoring

■Informs, consults and advises visitors of the DIMAK information office, face to face and virtual
■ Supports on preparation of the workshop material and gives lectures on options and requirements of labour migration to Germany
■ Conducts research, review, prepares and forwards relevant reports and documents
■ Helps update the office and project/programme website
■ Participates in organising events and looking after foreign delegations and VIP visitors
■ Supports development and monitors implementation of work plans for PME activities in Albania for the timely and realistic achievement of the project objectives
■ Supports the PME team Albania with relevant information, contacts and logistical support in the com-pilation of studies and surveys in Albania for results-based monitoring and management.
■ Supports with the necessary coordination processes to produce publications and materials in ac-cordance with GIZ standards (corporate design, standards for content)
■ Supports monitoring of customer interactions on social media, initiates conversations and provides appropriate responses where applicable

Financial services

■ Is responsible for the administrative/finance procedures, in cooperation with the GIZ Office, for the financing agreements and local subsidies, makes sure that the administrative procedures are in line with "Orientation and Rules" of GIZ;
■ Monitors income, expenditure and reports accordingly
■ Manages and monitors the regular accounting and financial plans of the financing agreements
■ Checks requests for funds before release
■ Carries out secretarial support and manages the filing system;
■ Follows up information flow and deadlines, prepares notification letters, archiving, agendas for meet-ings

Crosscutting Tasks

■Does backstopping to the project team on the ongoing developments on the topic of migration advice in Albania
■ Provides general administrative support
■ Updates the relevant folders of the GIZ Knowledge to facilitate access to key information for tenders such as project references, performance confirmations from clients etc.
■ Prepares various written outputs, such as background papers, correspondence with governments, working papers, mission reports, presentations and ad hoc reports and participates in relevant meet-ings and conferences in the area of migration in Albania
■ Participates in PME-related training programmes and involves actively in the development of the pro-gramme and the current topic of Migration and Development
■ Takes on additional and ad-hoc tasks related to the profile describes assigned by the coordinator of PME in Albania
■ Supports the coordination with Albanian, German and English speaking partners
■ Ensures good communication and flow of information within GIZ and with other relevant actors
■ Prepares and contributes to field missions and capacity-building activities, including the preparation of workshops and trainings in Albania and interprets the discussions etc.
■ Participant´s management, including travel costs reimbursement, participant registration, logistical issues of activities

Required qualifications, competences and experience:

■ BA/MSc qualification in Finance/Accounting or similar area
■ at least 2 years of experience preferably in similar position
■ ability to support a multi-task, multi-discipline programme team
■ excellent working knowledge of MS products, particularly Word, Excel and PowerPoint
■ fluency in written and spoken English, German language would be a strong asset
■ able to work in a team as well as independently
■ excellent social and communications skills

*Contract conditions*

■ Full-time employment
■ Project office in Tirana
■ Duration: 2 years

Please forward your application until 14th of January 2018, to GIZ Office Albania by E-Mail: giz-albanien-hr@giz.de , including the following information: Application letter, CV in English (Euro Pass format), refer-ences.
Only short-listed candidates will be contacted for interviews. They might be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates. *GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!*

# Arta Marku me ambasadorin italian: Bashkëpunim për hetime të përbashkëta

Ambasadori Italian Alberto Cutillo, ka zhvilluar ditën e djeshme një takim në Prokurorinë e Përgjithshme me Arta Markun, ku biseduan për bashkëpunimin mes dy shteteve. Në fokus të takimit, i cili zgjati rreth 30 minuta ishte reforma në drejtësi dhe dosjet e përbashkëta të bandave kriminale të trafikut të drogës mes Italisë dhe Shqipërisë. Cutillo i ka shprehur kryeprokurores Marku, gatishmërinë dhe mbështetjen totale për goditjen e grupeve kriminale, që veprojnë në vend, por edhe më gjerë. Shqipëria e konsideron Italinë një partner shumë të rëndësishëm në luftën kundër krimit të organizuar dhe trafiqeve. Në këtë kuadër, gjatë takimit, Prokurori i Përgjithshëm shprehu bindjen se Prokuroria Shqiptare dhe agjencitë ligjzbatuese italiane do të intensifikojnë koordinimin për hetime të përbashkëta dhe goditjen e grupeve kriminale që operojnë ndërmjet dy shteteve. Prokurori i Përgjithshëm, znj. Marku, falënderoi diplomatin italian për angazhimin e tij personal dhe të vendit të tij për nxitjen dhe kontributin në hartimin e reformës në drejtësi. Zonja Marku theksoi rëndësinë e procesit të vetingut në sistemin e drejtësisë në Shqipëri, duke u shprehur se forcimi i integritetit të prokurorëve dhe gjyqtarëve do të ndikojë edhe në rritjen e mëtejshme cilësore të luftës kundër krimit të organizuar dhe trafikut ndërkombëtar. Një tjetër temë e rëndësishme diskutimi ishte zbatimi i plotë i ligjit "Për dekriminalizimin". Ambasadori italian shprehu gatishmërinë për të bashkëpunuar me autoritetet shqiptare për realizimin në kohë sa më të shpejtë të procesit të verifikimit të integritetit të zyrtarëve shqiptarë.

Kryeprokurorja, Arta Markun

"Janë inspektuar zyrat e hipotekave të disa qyteteve, të godasim shkeljen e ligjit"

# Shkeljet në Hipoteka, Gjonaj shkarkon 8 punonjës

## *Ministrja e Drejtësisë: Qytetarët kanë adresuar 277 ankesa*

Ina Allkanjari

**TIRANE**

Ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj, në një deklaratë për mediat ditën e djeshme, lajmëroi shkarkimin e 8 punonjësve të Hipotekave, pas ankesave të qytetarëve për shërbimet në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në disa qarqe të vendit. Gjonaj u shpreh se Ministria e Drejtësisë mbetet e angazhuar maksimalisht për të trajtuar dhe zgjidhur ankesat e qytetarëve.

**DEKLARATA**

Në mbajtje të premtimit që qeveria ka bërë në fillim të mandatit të saj, për "Qeverisje në koalicion me njerëzit e zakonshëm", Ministria e Drejtësisë mbetet e angazhuar maksimalisht për të trajtuar dhe zgjidhur ankesat e qytetarëve. Vetëm gjatë muajve tetor - dhjetor të vitit që lamë pas, përmes platformës së bashkëqeverisjes "Shqipëria që Duam", në adresë të Ministrisë së Drejtësisë, qytetarët kanë shkruar dhe adresuar 277 ankesa, të cilat janë trajtuar në mënyrë serioze nga strukturat teknike të ministrisë nga vetë unë si ministre dhe kabineti im. Bazuar në ankesat e paraqitura, kam urdhëruar ngritjen e grupeve të posaçme të inspektimit, të cilët gjatë muajve nëntor-dhjetor kanë inspektuar zyrat e hipotekave të Fierit, Shkodrës, Elbasanit, Pogradecit dhe Korçës. Në përfundim të kontrolleve dhe hetimeve administrative, të kryera nga strukturat e Ministrisë lidhur me ankesat e qytetarëve, janë konstatuar shkelje të ligjit dhe vonesa të tejskajshme dhe të pajustifikuara në trajtimin e disa prej tyre. Për 15 ankesa të zgjidhura vetëm gjatë muajit dhjetor, zvarritjet janë disa vjeçare, në shkelje të hapur me ligjin dhe duke bërë që qytetarët të ndihen të pafuqishëm për të realizuar të drejtën e tyre.

Të vendosur për të goditur shkeljet e ligjit dhe veprimet korruptive, sot kam marrë masat administrative deri në shkarkimin e tyre, për 8 punonjës të zyrave të hipotekave në rrethet: Elbasan, Lushnjë, Fier, Durrës, Tiranë, Pogradec, Korçë dhe Shkodër që kanë pasur në trajtim këto raste. Dëshiroj t'i siguroj qytetarët, për angazhimin maksimal të timin si ministre, të Ministrisë së Drejtësisë, për të zgjidhur njëherë e mirë problematikat e tyre në regjistrimin e pronës, të cilat janë identifikuar nga ministria në bashkëpunim me Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Dëshiroj, gjithashtu, të inkurajoj të gjithë qytetarët që për çdo problem apo vonesë të pajustifikuar në marrjen e shërbimeve pranë këtyre zyrave apo çdo institucion tjetër ligjzbatues në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, të na drejtohen përmes platformës shqiperiaqeduam.al. Shqipëria që Duam, është një platformë e cila, që prej nisjes së saj, ka marrë fuqinë e përçuesit të zërit të qytetarit, me qëllimin e vetëm për t'i dhënë fund sorollatjeve në dyert e institucioneve shtetërore dhe për të luftuar korrupsionin, i çfarëdo niveli qoftë ai, duke treguar zero tolerancë ndaj abuzuesve dhe shkelësve të ligjit.

Ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj


**Primall Sh.p.k.**

**Shoqeria PRIMALL shpk** , distributor I autorizuar per Shqiperine I markave te kompanise nderkombetare "JT International", njofton se duke filluar prej dates 08 Janar 2018 cmimet e produkteve te tregtuara prej saj do te jene sipas listes me poshte:

| Marka | Cmimi nga data 08 Janar 2018 (TVSH e perfshire) |
|---|---|
| Camel Filter | 260 |
| Camel Blue | 260 |
| Winston Blue | 250 |
| Winston Super Slims Silver | 250 |
| Winston XStyle Blue | 230 |
| Winston XStyle Silver | 230 |
| Winston Blue 10's | 130 |
| Winston XStyle Black | 250 |
| Winston XStyle Gold | 250 |

Njoftimi behet ne perputhje me udhezimin nr 2 date 28.01.2010 te Ministrise se Financave dhe udhezimit nr 17 date 13.05.2008 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar).


# Pikaset gomonia në Vlorë dhe ndiqet nga mjete të tri shteteve, dyshohet se ka drogë

Delta Forcë, Policia Kufitare dhe D.V.P.Vlorë është vënë në ndjekje të një gomoneje ditën e djeshme rreth orës 13.50, nisur nga informacionet e marra në rrugë operative se mund të ishte fshehur lëndë narkotike me qëllim trafikimi. Policia kufitare e ka konstatuar mjetin lundrues të lëvizte me shpejtësi në drejtim të Mezokanalit, Sazan. Menjëherë në ndjekje janë vënë 3 mjete lundruese të Policisë Kufitare dhe të Delta Forcë. Eshtë kërkuar ndihma e anijes "Oriku" dhe e helikopterit të FA-së. Gjithashtu, është njoftuar GdF Durrës e Vlorë si dhe homologët Italianë. Dyshohet se gomonia do merrte lëndën narkotike në Sazan me qëllim trafikimin në drejtim të Italisë. Nga krehja e zonës në gadishullin e Karaburunit, në vendin e quajtur "Bristan", midis shkëmbinjve, policia ka gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale 28 kilogramë lëndë narkotike të ndarë në 5 pako. Policia Kufitare, Delta Forcë dhe Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë po vijojnë kontrollet në zonë.

## Kontrata, së shpejti punime për kirurgjinë e QSUT-së

# Risi, pacientët prenotim online për të marrë shërbim nga mjekët specializantë

Të gjithë ata qytetarë që e kanë të nevojshme të vizitohen te mjekët specializantë, tashmë do të mund të prenotojnë vizitën e tyre online. Kjo është bërë me dije nga kryeministri i vendit, Edi Rama, i cili theksoi se në këtë mënyrë do t'i jepet fund radhëve të gjata të pacientëve në dyert e spitaleve e procedurave burokratike nga një zyrë në tjetër. Aktualisht çdo qytetar dhidhet të drejtohet pranë mjekut të familjes, ku merr rekomandimin përkatës, një kod personal dhe prenoton orarin e vizitës online tek mjeku specialist. Por deri më tani, nuk ka pasur një mirëfunksionim të pjesës së orareve. Pacientët pasi merrnin rekomandimin te mjeku i familjes, prisnin në radhë edhe me orë të tejzgjatura për të bërë vizitën. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u shpreh se risia e fundit në shërbimin parësor mundëson shmangien e ecejakeve të shtuara të pacientëve nga sistemi parësor në sistemin sekondar sipas nevojës së tyre. Referimi elektronik aktualisht funksion vetëm në Kryeqytet dhe brenda 2018-ës pritet të shtrihet në të gjithë Shqipërinë.

**RISIA**

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u shpreh se risia e fundit në shërbimin parësor mundëson shmangien e ecejakeve të shtuara të pacientëve nga sistemi parësor në sistemin sekondar sipas nevojës së tyre. Referimi elektronik aktualisht funksion vetëm në Kryeqytet dhe brenda 2018-ës pritet të shtrihet në të gjithë Shqipërinë.

**KIRURGJIA E QSUT**

Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza do të ketë një strukturë të re spitalore për Kirurgjinë e Përgjithshme me bllok të ri të sallave të operacionit dhe reanimacionin e Kirurgjisë dhe me pajisje të teknologjisë së lartë. Në ambientet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u firmos kontrata për fillimin e punimeve të projektit nga Ministrja e Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu dhe Fabrizio Puccarelli, drejtor ekzekutiv i kompanisë INSO. Pas përfundimit të projektit, spitali i ri i do të ketë një kapacitet prej 120 shtretër, duke bërë të mundur transferimin e shërbimeve të Kirurgjisë së Përgjithshme me 3 klinikat e tij, në këtë strukturë të re në QSUT. Vlera e investimit është mbi 7.3 milionë euro, nga të cilat, rreth 4 milionë euro do të investohen në pajisje mjekësore të teknologjisë së lartë.

Foto ilustruese

## Ministria e Punëve të Brendshme zbardh detajet, çfarë përmban dokumentacioni

# Hapet tenderi 1.4 milionë euro për ushqimin te Spitali Ushtarak

## *Kontrata me operatorin fitues, 4 vjet e vlefshme*

Është hapur procedura e tenderimit për shërbimin e gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit për Spitalin Universitar të Traumës. Ministria e Punëve të Brendshme ka përcaktuar fondin limit pa TVSH prej 188.2 milionë lekë, ose rreth 1.4 milionë euro për shërbimin e kateringut. Operatori që do të shpallet fitues i këtij tenderi do të ketë një kontratë 4-vjeçare për të kryer shërbimin e përcaktuar. Kontrata thekson se operatori duhet të ofrojë përgatitjen e ushqimit, paketimin dhe ambalazhimin, transportin deri tek pavione sipas orareve të servirjes, shpërndarjes dhe servirjen deri te pacienti dhe mjeku roje. Sipas dokumentacionit, ushqimi do të shpërndahet në varësi të dietave të përcaktuara, si: dieta normale, e cila zë edhe pjesën kryesore të porosisë; dieta hidrike; dieta e lëngët; dieta për ulcerozën; dieta diabetike; dieta për mjekët; etj. Dieta normale përfshin këto asortimente: 300 ml qumësht, 15 gr sheqer, 250 gr bukë, 150 gr oriz/makarona, 500 gr zarzavate, 30 ml vaj, 150 gr mish, 300 gr fruta, 80 gr djathë/gjizë, 10 gr gjalpë. Ndërsa dieta për mjekët duhet të përfshijë rreth 4300 kalori në ditë dhe përbëhet nga: 600 gr bukë gruri, 60 gr oriz, 50 gr makarona, 60 gr fasule, 200 gr mish vici, 30 ml vaj për gatim, 10 ml vaj për sallatë, 30 gr gjalpë, 50 gr sheqer, 50 gr sallam/proshutë, 40 gr djathë i bardhë, 300 ml qumësht, 1 kokërr vezë, 500 gr perime, 250 gr fruta, 30 gr reçel, 3 gr salcë, çaj maji, kripë dhe erëza. Kërkesat për operatorët ndërkohë përfshijnë punësimin e të paktën 20 punonjësve, si edhe realizimin e shërbimeve të ngjashme gjatë 3 viteve të fundit në të paktën 40% të vlerës së fondit limit.

Rëndësia e këtij shërbimi përshkruhet edhe në dokumentet e tenderit, ku sipas përshkrimit, përgatitja e ushqimit në cilësinë e duhur në bazë të dietave e kalorive do të ndikonte në uljen e ditëqëndrimit të pacienteve në spital, si dhe uljen e përdorimit te medikamenteve nga ana e tyre. ky tender do të qëndrojë i hapur deri më 29 janar të këtij viti, datë pas së cilës do të shpallet edhe operatori fitues. Kushtet e tenderit përcaktojnë që shërbimi do të jetë 24 orë në ditë për 7 ditë të javës, ndërsa personeli i operatorit fitues duhet të kryejë edhe pastrimin e tavolinave dhe ushqimin e të sëmurëve rëndë që nuk kanë kujdestar, duke siguruar për këta të fundit edhe tavolina lëvizëse. Ndërkaq, vlera e kontratës do të rishikohet në rritje vit pas viti.

**PËRMBAJTJA E KONTRATËS**

Kontrata thekson se operatori duhet të ofrojë përgatitjen e ushqimit, paketimin dhe ambalazhimin, transportin deri tek pavionet sipas orareve të servirjes, shpërndarjes dhe servirjen deri tek pacienti dhe mjeku roje. Sipas dokumentacionit, ushqimi do të shpërndahet në varësi të dietave të përcaktuara, si: dieta normale, e cila zë edhe pjesën kryesore të porosisë; dieta hidrike; dieta e lëngët; dieta për ulcerozën; dieta diabetike; dieta për mjekët; etj.

**188.2**

**MILIONË LEKË USHQIMI TE USHTARAKU**

Është hapur tenderimi për ushqimin te Spitali Ushtarak i Tiranës, i cili do të zgjasë deri në 29 janar të këtij viti. Ministria e Punëve të Brendshme ka përcaktuar fondin limit pa TVSH prej 188.2 milionë lekë, ose rreth 1.4 milionë euro për shërbimin e kateringut. Operatori që do të shpallet fitues i këtij tenderi do të ketë një kontratë 4-vjeçare për të kryer shërbimin e përcaktuar. Ndërkaq, vlera e kontratës do të rishikohet në rritje vit pas viti.

## Bashkia e Tiranës, punime për korsitë e biçikletave dhe rrjetin e ujësjellësit

Kanë nisur punimet për ndërtimin e korsive të reja në kryeqytet. Kryebashkiaku Erion Veliaj ka deklaruar se 2018-a do të jetë vitit i biçikletave. Investimi më i fundit i bashkisë është ai në rrugën e Kavajës dhe në rrugën e Dibrës. Për ndërtimin e korsive të dedikuara në rrugën e Kavajës është përdorur trotuari i mesit në mënyrë të ngjashme me atë që është ndërtuar në bulevardin 'Zogu I'. Ky investim që kushton rreth 33 milionë lekë do të jetë gati pas tetë javëve. Gjatë këtij viti Bashkia e Tiranës ka planifikuar të ndërhyjë edhe në disa rrugë të tjera të kryeqytetit me qëllim ndërtimin e infrastrukturës së duhur për përdoruesit e biçikletave. Ndërkaq, një tjetër investim i rëndësishëm në një nga rrethinat e kryeqytetit po merr jetë. Pas shumë vitesh, përmes rrjetit të ri të shpërndarjes, furnizimi me ujë në zonën e njohur të Fushë-Mëzezit do të kryhet brenda të gjithë parametrave, për të ofruar të njëjtën cilësi shërbimi si në qendër ashtu edhe në rrethinat e Tiranës. Bashkia e Tiranës vazhdimisht u ka bërë thirrje banorëve që të formalizojnë lidhjen e tyre me UKT përmes lidhjes së kontratave të furnizimit me ujë dhe kanalizime. Ndërkohë, ndonëse ka qenë periudhë festash, në rrugën "Daniel Ndreka", specialistët e UKT ndërhynë për riparimin e problematikës së shfaqur kohët e fundit pas sinjalizimit të banorëve.

3H

**SHOQËRIA PËRMBARIMORE GJYQËSORE "3H" Sh.p.k**

Adresa: Rr." Demokracia" Pll.1, Kt.1, Vore, Tirane.
Web: www.3-h.al; Email: shpgj_3h@yahoo.com Tel/Fax +355(0) 44532482

Njofton shpalljen e ankadit nga **dt.26.12.2017 deri ne dt. 12.01.2018** per: sende të luajtshme tubosider me siperfaqe totale 13539.5m2 dhe peshe 258034.15 kg, (me madhesi te ndryshme) si dhe dado dhe bulona me peshe totale 12160 kg, ne pronesi te Shoqerise "Serenissima Construzioni Tirana" Dege e shoqërisë së huaj
**Cmimi fillestar eshte 163,413.43 Euro**
**Ankandi zhvillohet ne zyren permbarimore ne daten 12.01.2018 dhe mbyllet me orarin zyrtar 16.00.**

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

**Ne date 08.01.2018 ne oren 16.00** ne zyren e permbaruesit gjyqesor privat **Irisa Tereziu PF** me adrese ne "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njesia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankandi per shitjen e pasurise se paluajtshme te llojit llojit "Apartament" me siperfaqe 52.01 m², me volum 1, faqe 175, numer pasurie 1/214+2-15, ne zonen kadastrale 1664, me adrese Lagjia "Puntori", Pll.14, Shk.2, Kt.3, Ap.15, Fushe Kruje.Cmimi ne ankand te trete eshte ne vleren 1,225,504.22 (nje milion e dyqind e njezet e pese mije e peseqind e kater pike njezet e dy) lekë.

# BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA

Nr. 592

SUPLEMENT I PERJAVSHEM
E shtunë 6 Janar 2018

GAZETA SHQIPTARE

Art Designer: Nevila Samarxhi


RREFIMI EKSKLUZIV

# BLEONA QERETI, këngëtare në darkën e miliarderëve

## Është apo jo e dashura e Remo Ruffini-t? Përgjigjen e jep mikesha e saj

MODELJA
ORIOLA MARASHI

NXJERR FOTO TOPLES, REAGON ASHPER PAS KOMENTEVE TE FANSAVE

ANGELA MARTINI:
FUSTANIN E ZI E ZGJODHI DRAGOS

## ALESIO ALIA: Baba për herë të dytë! Ju rrëfej si e zbulova lajmin dhe urimi i Drake

*Flet modeli: Nga çfarë të heq dorë? Tani e hedh gurin e fsheh dorën*

# Seldi feston ditëlindjen, ja urimi i ndjerë i Mimozës

Ata janë një nga çiftet më simpatike dhe të rinj të momentit. Dashuria dhe për më tepër, fejesa e tyre ishte e papritur për të gjithë ne. Kemi parë shpesh Seldin t'i bëjë dedikime romantike së fejuarës së tij, por mesa duket, nuk di vetëm ai të shprehë ndjenjat. Sot ka qenë pikërisht Mimoza Shkodra, e cila e ka uruar atë në "Instastory" duke shprehur hapur dashurinë..."Urime jeta ime, u bëfsh 100! Të dua", i shkruan ajo. Kaq mjafton për të shprehur shumë, apo jo?

# Xhemi feston ditëlindjen, Arbana i "nxjerr të palarat" në "Instagram"

Prej kohësh jemi njohur me miqësinë e ngushtë të dy moderatoreve të njohura të TCH, Arbana Osmani dhe Xhemi Shehu. Para dy ditësh Xhemi festoi ditëlindjen e saj, ndërsa mori një surprizë shumë të këndshme nga Arbana dhe Eno Popi. Ata i vajtën në shtëpi në mesnatë për ta uruar, një gjest i cili e emocionoi shumë Xhemin. Por me sa duket "surprizat" e Arbanës nuk paskan mbaruar ende. Ajo ka nisur të postojë "arsenalin" e fotove që ka me Xhemin, e duhet ta themi se nuk e dimë nëse Xhemi do të jetë e lumtur kur t'i shohë. Pa dijeninë e saj, Arbana ka postuar dy foto mjaft interesante. Në njërën foto ajo shfaqet e ulur në prehrin e Xhemit, kur kjo e fundit është maskuar si mashkull për një rol në "Portokalli". Ndërsa në tjetrën Xhemi shfaqet duke lyer flokët. Dhe duke njohur shumë mirë shoqen e vet, në një nga diçiturat e fotos Arbana shkruan: "E fundit, para se të më ekzekutojë përfundimisht". Kujtime të bukura pavarësisht detajeve. Sa tolerante paska qenë Xhemi!

# Modelja nxjerr foto toples, reagon ashpër pas komenteve të fansave

Jo më larg se një ditë më parë, modelja Oriola Marashi postoi një foto toples të saj duke mbuluar gjoksin në faqen e saj në "Instagram" me nënshkrimin: "…Jam e lumtur që jam gjallë për sa kohë mund të shpreh veten. I inkurajoj të gjitha gratë që duan ta shprehin veten e si e ndjejnë."

Dmth te gjitha ju qe nxirrni keshtu na qenkeni kreative Ah medet medet thuaj I paska ndryshuar kuptimi kreativitetit, sa e lehte eshte sot te jesh kreativ.. Nxirr e shfaq ca te duash moj vajze, por lexo pak me shume qe te jesh kreative , se ke gjera te tjera po mend fare ..

Por një reagim jo i mirë ka pasuar nga ndjekësit e saj, të cilët nuk e pritën mirë këtë postim duke komentuar se duhet të lexojë dhe jo ta shprehë kreativitetin në këtë mënyrë. Gjithashtu, nuk kanë harruar edhe ta ofendojnë në komentet e bëra. Oriola, nga ana tjetër, s'ka ndenjur gojëkyçur duke i kthyer një përgjigje të gjithë atyre që kishin ankesa. Ndërkohë që ajo shkruan një postim në faqen e saj në "Instastroy" ku thotë se çdokush mund të bëjë ç'të dojë me jetën e vet:

Nëse dikush do të më quante ku*vë në jetën reale, do e kisha rrahur (është instinkt malokeje). Po e keni parasysh, kështu janë gjërat që shohim në media. Çdokush që bën diçka me jetën e tij është një ku*vë. Më lëndon vërtetë, sepse më bën t'i urrej njerëzit. Jam e lodhur nga perceptimi se si mund ta presin njerëzit Oriolën. Feminizmi s'është përshtatje, është zgjedhje e lirisë. Nuk po e justifikoj foton time si feminizëm fuqizues, se është thjesht një foto artistike, por po ju tregoj ju që për sa kohë s'paguani faturat e mia, s'paguani për gjërat e mia, s'ju marr fare në konsideratë! Unë punoj, kam punuar që kur isha 16 vjeç. I paguaj vetë faturat e mia. Ndihmoj prindërit, gjyshërit. Në vend të më gjykoni mua, o brezi i 97-s, zgjidhni të më pranoni ose jo. Unë s'jetoj për [aprovimin] tuaj. Jam e lumtur dhe e dua veten. Duajeni veten, dilni, punoni, bëni miq, bëni gjëra idiote, thyeni tabutë, një jetë kemi! Dhe kur të më vijë mosha për burrë, do e mbaj dhe me muhabet tek dhoma e gjumit. Do ia bëj dhe mëngjesin, po me radhë."

### Është apo jo e dashura e Remo Ruffini-t? Përgjigjen e jep mikesha e saj

# BLEONA QERETI, këngëtare në darkën e miliarderëve

*Pasuria e të ftuarve, mbi 30 miliardë dollarë… Rrëfehet artistja e make up-it: Bleona, mikesha e tyre. Organizoi koncert për ta brenda një dite*

Suela Çangu me Eva Cavalli-n



Bleona Qereti me Remo Ruffini-n

Bleona Qereti me miqtë e saj

Emri i saj ishte sërish në qendër të të gjitha media ve në Shqipëri edhe gjatë javës që po lëmë pas… Bleona Qereti kaloi mbrëmjen e ndërrimit të viteve në shtëpinë e multimiliarderit, pronarit të markës së famshme "Moncler" dhe kaq mjaftoi që mediat në vendin tonë të aludonin për një histori të mundshme mes këngëtares shqiptare dhe biznesmenit të njohur. Me apo pa dashje, të gjithë e anashkaluan emrin e Fracesca Ruffini-t, bashkëshortes së Remos, 56 vjeç, baba i dy fëmijëve, të bërë 'tagg' në çdo postim të Bleonës.

"**Bluetooth**" ka mësuar se Bleona nuk ishte e vetmja shqiptare në festë… Artistja e njohur e 'make up'-it, Suela Çangu, ishte gjithashtu pjesë e kësaj mbrëmjeje të paharrueshme në shtëpinë e boss-it të "Moncler", ku ishin të ftuar edhe shumë investitorë të mëdhenj e njerëz nga bota e modës. Vetë Suela rrëfen për ne gjithçka ndodhi ato dy ditë në shtëpinë e Remo Ruffini-t.

**Suela, na trego pak, kush të ftoi në festën private të CEO-s së "Moncler"?**

Bleona, kush tjetër… Ajo ishte e ftuar nga të zotët e shtëpisë si mysafire me rastin e festave të fundvitit, bashkë me miq të tjerë të sajët, emra si Sara e Giovanna Bataglia, Eva Cavalli, etj. Remo i kish kërkuar të këndonte dhe Bleona si Bleona, kur mori vesh që mbrëmjen e ndërrimit të viteve do të kishte 300 të ftuar në shtëpinë e tij, vendosi të organizojë një koncert. Më mori mua nga Shqipëria për 'make up', solli nga SHBA të gjithë arsenalin e saj të veshjeve dhe stolive të luksit, nisi provat me koreografin Ettiene Russo (një nga më të njohurit e pasarelave) dhe ja kështu, u bëra edhe unë pjesë e festës.

**Dimë që pjesë e festës kanë qenë edhe shumë personazhe të tjerë me influencë në botën e biznesit, apo jo?**

Sipas asaj që Remo (zotërues i një pasurie prej 2.3 miliardë dollarësh) tha me shaka, vetëm 3 prej atyre që ishin në festë kishin pasuri 12-fishin e GDP-së së Shqipërisë për një vit. Nga ato që unë munda të mësoj, pjesë e festës ishte Andrey Melnichenco, një prej 100 njerëzve më të pasur në botë (zotëron një pasuri personale prej 13.8 miliardë dollarësh), familja Elkann, zotërues të kompanisë më të madhe të automobilave në botë, ku përfshihet edhe "Ferrari" (zotërojnë një pasuri prej 150 miliardë dollarësh), si dhe plot aksionerë nga marka shumë të njohura në botë si "Givenchy", "Bvlgari", etj.

**Çfarë bëri Bleona atje?**

Mbajti koncert për një orë dhe duhet ta them, që i argëtoi të gjithë atë natë me atë çfarë kishte përgatitur. Bleona ka vërtet energjinë e një ylli, doli në 'after party' me një peshqir të bardhë të qëndisur me perla nga Eva Cavalli dhe të gjithë sytë ishin nga ajo.

**Që të jemi të qetë ne, Bleona nuk ishte e dashura e asnjërit prej tyre?**

Bleona ishte e ftuar si mikesha e tyre, siç e thashë edhe më lart, i zoti i shtëpisë, Remo Ruffini i kish kërkuar që të këndonte vetëm një këngë, por kur ajo mori vesh që do të ishin 300 të ftuar (mes tyre 72 miliarderë), vendosi që të gjithën këtë ta shndërronte në koncert. Sa për meshkujt e ftuar në festë, kishte një varg prej tyre që i rrinin para mbrapa, me përfundimin e performancës, por Bleona si Bleona, do të jetë e adhuruar nga 100 vetë, jo vetëm nga njëri.

**INTERVISTA / U njohëm gjatë një 'party' në shtëpinë e tij, që sot është shtëpia jonë. Unë isha pa "make up"**

# ANGELA MARTINI:

## Fustanin e zi e zgjodhi Dragos. Kur e vesha, ndjeva se nuk po shkoja drejt një martese të mërzitshme

Angela Martini ka rrëfyer për një intervistë në mediat rumune të gjithë marrëdhënien e saj me pasanikun Dragos Savulescu. Në rrëfimin e siguruar nga revista "Who", Martini tregon se si u njoh me bashkëshortin e saj, dasma me të cilin thotë se ishte pa plan… "U zgjuam një mëngjes dhe thamë le të martohemi", - shprehet Angela. Për më shumë lexoni intervistën!

**Angela si ndihesh?**

Jam shumë mirë dhe shumë e lumtur.

Dashuria që keni për njëri-tjetrin dallohet në sytë tuaj…

Po, është e vërtetë jemi shumë të lidhur me njëri-tjetrin dhe jemi me fat që jemi njohur.

**Le të flasim pak për dasmën. Një dasmë e organizuar në Las Vegas, në mesnatë, ideja e kujt ishte?**

Nuk ishte e planifikuar, në fakt u vendos në momentin e fundit. Ne as nuk u fejuam më parë. Ishim në LA dhe një nga miqtë tanë na ftoi të shkojmë në Vegas. Unë dhe Dragos ramë dakord dhe në mëngjes ditën përpara se të niseshim për në Vegas, u zgjuam pranë njëri-tjetrit dhe duke u parë në sy thamë le të martohemi. Filloi si një shaka.

**Kush nga ju të dy e tha i pari frazën "le të martohemi"?**

As nuk e mbaj mend në fakt. Kujtoj vetëm që u zgjuam dhe i thashë Dragos "të dua", ai m'u përgjigj "edhe unë të dua". Dhe aty filluam duke thënë le të martohemi, si fillim me shaka. Pastaj u kthye në serioze çdo gjë. Shkuam në Vegas dhe i thashë shoqes sime që do martohemi. Ajo sigurisht që u çudit, por ne e kishim ndarë mendjen. Nuk njoftuam prindërit, miqtë, askënd. Nuk kisha as unazë, as fustan, asgjë. Dhe të gjitha këto i gjetëm ditën tjetër në vetëm një ditë.

**Më trego, si ishte dasma jote e paplanifikuar?**

Ishte e mrekullueshme në të vërtetë, nëse do kisha një jetë të dytë, do e bëja përsëri në të njëjtën mënyrë. Ishte

pikërisht siç e ëndërroja, sepse unë kurrë nuk kam dashur një dasmë tradicionale, ku shkëmbehen unazat, e planifikon për një vit të tërë dhe është më shumë për njerëzit e tjerë sesa për ty. Për mua ka rëndësi momenti, energjia mes dy personave dhe universi, jo dëshira për t'u shfaqur, për të pasur fustanin më të shtrenjtë apo diçka tjetër të ngjashme.

**Pra, për ty ka pasur rëndësi ai shikim në sytë e partnerit dhe çasti, jo dëshira për një dasmë të shtrenjtë…**

Pikërisht, të qenit spontane, kjo e bëri dasmën të paharrueshme për mua, e bëri të duket si një film.

**Le të kthehemi te dasma, më trego momentin që shkele në altar, njëlloj si t'ia tregosh një shoqeje, zëre sikur më more në telefon dhe më the "hej unë u martova dje"…**

Drago u zgjua dhe të dy filluam të kërkojmë për një altar dhe zgjodhëm më të voglin. Ceremoninë vendosëm ta bëjmë në mesnatë.

**Pse në mesnatë?**

Për mua, mesnata është momenti më romantik, kur edhe hëna është e plotë. Nuk e di, ndoshta kam parë shumë filma dhe kjo ka ndikuar tek unë. Pastaj shkuam të gjejmë unazat. Ai gjeti të vetën, unë timen.

**Mund ta shoh unazën?**

Po patjetër, kjo në fakt është vetëm unaza provizore, e vërteta akoma po punohet.

**Por ti gjithsesi do e mbash edhe këtë apo jo?**

Patjetër, edhe këtë, edhe tjetrën. Unë shkova për 'shopping' me shoqen time, për të gjetur një veshje që të kisha mundësi më vonë për të organizuar gjërat e tjera, por ora shkoi 18:30 dhe unë i telefonova Dragos dhe i thashë: "I dashur, unë nuk kam një fustan, nuk mund të gjej asgjë, nuk e di çfarë të vesh"… Ai më tha "mos u shqetëso" dhe vendosi që të mos vishesha me një fustan të bardhë, sepse e zgjodhi ai çdo gjë për ne.

**Pra, atë fustan të zi aq seksi e zgjodhi ai për ty?**

Po, ishte ideja e tij. Ai më tha mos u shqetëso, unë do të të gjej çdo gjë. Ai erdhi dhe më tha 'di tre dyqane', bëri zgjedhjen dhe unë isha duke parë fustanin dhe i thashë "Nuk mund të martohem kështu". Ai më tha ky fustan është unik, është ndryshe nga të tjerët dhe ti kështu duhet të vishesh.

**Si u ndjeve në atë fustan?**

U ndjeva mirë, u ndjeva ndryshe, ndjeva se ne nuk do të shkonim drejt një martese të mërzitshme, po ndihesha si në një aventurë, jo sikur jeta ime po mbaron, por sikur jeta ime sapo filloi. Ishte shumë emocionuese. Ne nuk kishim kohë për asgjë.

**A kishit ndonjë mik me vete?**

Kishte disa miq që po na prisnin, por askush nuk e dinte se ne do të martoheshim, ata prisnin që ne të luanim, edhe pse vetë martesa është një lojë e madhe. Pastaj pas dasmës, ne kërkuam të hanim pica, sepse ishim shumë të uritur.

**A ka diçka që të mërzit**

**nga Dragos, por që është edhe e bukur?**

Diçka që jo se më mërzitet, por që është shumë e bukur, ose e ëmbël nga ana e tij është momenti kur shqetësohet nëse diçka po shkon keq me mua. Për shembull, nëse unë filloj të kollitem, ai fillon të shqetësohet shumë, më shikon nëse kam temperaturë, ose më thotë eja të shkojmë tek mjeku. Kujdeset shumë për mua dhe nëna ime e pëlqen shumë këtë gjë. Kujdeset për mua më shumë se prindërit e mi.

**Pse re në dashuri pikërisht me të?**

Kjo është shumë e thjeshtë. Unë kam udhëtuar në shumë vende të botës, jo si turiste, por jam rritur nëpër këto vende dhe të jetosh, e të jesh turist janë gjëra shumë të ndryshme nga njëra-tjetra. Unë kisha akses në çdo gjë, kam njohur djem, burra të niveleve të ndryshme, burra të suksesshëm ku çdo gjë shkëlqen nga jashtë. Nuk arrita të njihja një person që ishte i thellë, shpirtëror, inteligjent, i ngrohtë, i kujdesshëm dhe një ëndërrimtar. Sepse unë kam njohur djem që kanë pasur lekë nga prindërit e tyre, por nuk është e njëjta ambicie, e njëjta ëndërr. Kam njohur djem që lekët i kanë ndryshuar, që nuk besonin tek ëndrrat dhe tek shpirtërorja. Pastaj kam njohur djem që nuk besonin në dashuri, apo djem që thonë "Ti je gruaja ime", por atyre nuk u intereson për ty. Kur takova Dragos, zbulova se ai ishte një ëndërrimtar, që kishte një botë dhe donte ta tregonte.

**A e kuptove këtë që në momentin e parë?**

Në fakt ishte një dashuri me shikim të parë. Ne kishim shumë miq të përbashkët dhe unë isha duke darkuar me mikeshat e mia kur ai mori në telefon dhe tha: "Ejani në shtëpi, kemi party". Unë isha pa make-up dhe nuk kisha dëshirë të shkoja. Mikeshat më pas më mbushën mendjen dhe pranova. Ne shkuam atje dhe unë hyra në kuzhinën e shtëpisë së tij, që tashmë është shtëpia jonë. Thjesht i hodhëm një shikim njëri-tjetrit dhe u përshëndetëm. Ne ndjemë një energji mes njëri-tjetrit. Unë isha duke folur me persona të tjerë dhe ai afrohej shumë tek unë, por nuk më fliste. Më pas filluam të flisnim dhe në fillim folëm për shpirtëroren, për tema të thella si: pse jemi në këtë botë, ku do të shkojmë dhe unë mbeta e habitur nga ato që ai thoshte. Mendoja se po tallej, thjesht po shtirej. Një javë më pas patëm takimin tonë të parë. Ai më shkroi mesazh për një darkë dhe folëm shumë për shpirtëroren, për jetën dhe ai donte të më puthte. Më pas vazhduan takimet e tjera dhe një muaj më pas erdhi dhe puthja e parë.



**Ti dhe Dragos keni tatuazhe të njëjtë?**

Po, unë kam gjysmën e zemrës dhe gjysmën tjetër e ka ai. I bëmë këto tatuazhe një javë pas lidhjes sonë.

**Çfarë të pëlqen të bësh bashkë me Dragos?**

Të shikojmë filma. Ne i dashurojmë filmat, dokumentarët, të lexojmë, të takojmë miqtë tanë dhe të shkojmë për "shopping".

**A organizoni, ose shkoni në shumë 'party'?**

Ne kemi një 'party' të madhe çdo vit në shtëpinë tonë, gjithmonë në Los Angeles.

**A shpenzon kohë me miqtë e tu?**

Ata vijnë shpesh në shtëpinë time në Los Angeles, unë shkoj në shtëpitë e tyre. Shohim filma, shkojmë për darka, nuk shkojmë shumë në 'party'.

**Ti fole për 'shopping' dhe the se Dragos zgjedh veshjet e tua...**

Unë kam një burrë të veçantë. Ndryshe nga gjithë njerëzit e tjerë që njoh, ai përfshihet shumë në zgjedhjen e veshjeve të mia. Kështu, kur shkojmë për 'shopping', ai zgjedh çdo veshje timen.

**A ndihesh konfidente, ndihesh mirë me zgjedhjet e tij?**

Po, veshjet më të bukura i kam nga Dragos.

**Si ishte Krishtlindja jote në Rumani?**

Krishtlindja e parë në Rumani ishte shumë këndshëm, ndryshuam shtëpinë këtu dhe e festuam në mënyrën që ne dëshironim. Kishim familjen këtu dhe ishte diçka shumë e rehatshme, e dashurova këtë festë në Rumani. Prindërit e Dragos janë të preferuarit e mi.

**Është shumë bukur të keni këto marrëdhënie të veçanta, ti me prindërit e tij dhe ai me prindërit e tu...**

Unë çuditem kur dëgjoj shpesh që nuk e dua vjehrrën time. Unë e dua shumë vjehrrën time.

**A janë takuar prindërit tuaj me njëri-tjetrin?**

Po, sigurisht që janë takuar. Mamaja ime është takuar me prindërit e Dragos, ndërsa babai ende.

**Pra, e shijove Krishtlindjen në Rumani?**

Po, shumë. Konsumuam ushqime speciale, që unë nuk e di se si quhen, por ishte diçka xhelatinoze.

**A ke ti miq nga Rumania si psh., Alina Puscau?**

Alina ka qenë mikja ime përpara se të njihja Dragos, e kam njohur në Nju Jork. Madje, ne ishim në qershor këtu të dyja bashkë.

**Çfarë keni në plan me Dragos tani së shpejti? A do të shkoni në muaj mjalti?**

Do të shkojmë në Zvicër dhe më pas në Seychelles për muaj mjalti.

**Kush e zgjodhi këtë destinacion?**

Dragos, unë asnjëherë nuk kam qenë atje. Dragos ka qenë dhe më tha që është një nga vendet më të bukura në botë.

**A mund të japësh një këshillë për ata persona që ende nuk e kanë gjetur dashurinë e vërtetë, ose ata që nuk besojnë në dashurinë e vërtetë?**

Këshilla që jap është që së pari të besojnë në dashuri. Për çfarë vlen jeta, nëse nuk ka dashuri? Duhet të duash çdo herë sikur nuk je lënduar asnjëherë më parë.

Flet modeli: Nga çfarë të heq dorë? Tani e hedh gurin e fsheh dorën

# ALESIO ALIA:

## Baba për herë të dytë! Ju rrëfej si e zbulova lajmin dhe urimi i Drake

***Viti 2018 është viti i ndryshimeve. Për çdokënd ai ka nisur me evente e pritje të rëndësishme në jetë. Në këtë numër të parë të "Bluetooth"-it, për këtë vit do të flasim për "dhuratën" që i ka sjellë ky vit i ri një prej figurave të njohura të mediave rozë. Ai më parë ka qenë kryefjala e tyre për shkak të marrëdhënies që kishte me një deputete shqiptare, ndërkohë që nga ajo kohë duket se gjithçka ka ndryshuar për të. Po flasim pikërisht për Alesio Alian, modeli nga Tropoja, i cili tashmë duket se ka rilindur. Në një intervistë ekskluzive për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare" Alesio vjen krejt ndryshe. Ai na ka rrëfyer se si e zbuloi lajmin e bukur të të bërit baba për herë të dytë, cili nga personazhet VIP ndërkombëtar e ka uruar për herë të pare. Gjithashtu, ai ka zbuluar edhe planet që ka për dasmën me partneren Kathrine si dhe ku dëshiron ta realizojë atë. Për më tepër në intervistën e mëposhtme.***

Pamela Aliaj

**Si e priti vitin e ri familja e Alesios tani që s'do të jeni më 3?**

Më mirë se kur ishim 2. Një ndër fundvitet më të mira që kam kaluar.

**Çfarë planesh ju presin t'i realizoni për 2018?**

Tashmë nga 3 do të bëhemi 4. 2018 më sjell një bebe tjetër që është djalë. Dhe shumë surpriza lidhur me punën .

**Ju kanë bërë ndonjë propozim për punë? Bëhet fjalë për modeling?**

Nuk më intereson, edhe pse kam pas shumë raste që më bëjnë oferta herë pas here. Puna ime tashmë është e lidhur me evente, koncerte dhe organizime "After Party's".

**Cili ka qenë urimi më i veçantë për lajmin e fëmijës së dytë nga njerëzit e njohur?**

Drake ishte në Australi kur unë mora vesh që do të bëhesha sërish baba me një djalë. Ai më uroi natën e fundit që ishte në Melbourne të Australisë.

**Si e morët vesh lajmin e shtatzënisë?**

Isha në Tiranë dhe po vendosnim ditën e dasmës për 2018. Pas disa ditësh që e kishim vendosur, mora vesh që ishte shtatzënë dhe vendosëm ta shtyjmë dasmën.

**Keni pozuar për disa revista, do të vazhdoni të bëni të njëjtën gjë dhe në të ardhmen?**

Siç thashë edhe më parë, nuk më intereson më modelingu. Kam pozuar para shumë kohësh, jam akoma

*"E shkuara mbetet e shkuar, nuk jam penduar asnjëherë dhe çdo gjë e kam bërë për qejf"*

në formë të mirë sportive se me pëlqen të mbaj veten në **formë**, por jo për pozime revistash. Të jesh në formë është një stil jete.

**Ka qenë ndonjë revistë apo agjenci modelingu që ju ka propozuar një projekt interesant?**

Po, ka qenë para 1 muaji një agjensi që kam pas punuar në Singapor. Por nuk më interesonte. Tani nëse më vjen ndonjë ofertë që ja vlen, edhe mund ta pranoj.

**Me çfarë pune merreni tani Alesio? P o Katherine?**

Kam më shumë se 5 vite që merrem me 2 punë. Kam 2 restorante italianë në Melbourne me 2 shokë italianë.

Një quhet "Eat Ialiano" dhe tjetri quhet "Mascalzone". Dhe puna e dytë është kompania ime, "Boss Management" për evente, koncerte, dhe merrem me organizimin e të gjitha "After Party's"-ve për këngëtarët internacionalë që vijnë në Australia. Këngëtarët e fundit kanë qenë Drake dhe "The Weekend". Ndërkohë që Katherine punon nga shtëpia tani, ka një ambient të veçantë të cilin e përdor si sallon bukurie e për terapi.

**Jeni gjithnjë midis Shqipërisë dhe Australisë. Çfarë ju tërheq më tepër në vendlindje?**

Për vendlindjen nuk besoja kur dikur dëgjoja njerëzit që thoshin s'ka si vendi yt. Nuk më mungon asgjë këtu ku jetoj, por gjithsesi si vendlindja ime nuk ka. Edhe pse jemi akoma shumë mbrapa, vendlindja më mungon çdo ditë. Dhe aty do rikthehem një ditë.

**Nga se bëhet më tepër xheloze Kathrine? Po ju?**

Ajo nuk është një person xheloz prandaj e dua. Në këtë industri që jam unë nuk mund të kesh një partner xheloz.

**Keni menduar ndonjë emër për djalin? Shqiptar apo i huaj?**

Djali do ketë një mbiemër shqiptar, por jo një emër shqiptar. Do ketë një emër shumë të bukur.

**Në intervistën e mëparshme për "Bluetooth" thatë që dasma do të bëhet në 2018. I keni nisur përgatitjet apo...ndryshim planesh?**

Të thashë dhe më parë që planet ndryshuan nga fëmija i dytë.

**Nëse do të bëhet ku dhe kur e keni menduar?**

Në Tiranë, patjetër. Në asnjë vend të botës, përveçse aty.

**Më parë jeni përfolur tepër për jetën tuaj "të shfrenuar" prej zhigolo-je dhe marrëdhëniet e shumta që keni pasur me disa deputete të njohura. Jeni penduar për ndonjë gjë në jetën tuaj? A do të ndryshonit ndonjë pjesë të së shkuarës?**

E shkuara mbetet e shkuar. Mendojmë për momentin që jetojmë tani. Nuk jam penduar asnjëherë dhe çdo gjë që e kam bërë, e kam bërë për qejf. Zhigolo s'kam qenë asnjëherë, e në jetë më ka ndodhur të takoj shumë femra të punëve të ndryshme. Kam një karrierë të lashtë si Roma dhe unë.

**Kathrine kur ju ka njohur e ka ditur të shkuarën tuaj. Çfarë reagimi ka pasur ajo?**

Të gjithë kemi nga një histori. Unë kam pak më shumë se të tjerët, por kam edhe një gjë shumë të mirë; i bëj njerëzit të harrojnë të kaluarën time.

**Sa ka ndryshuar Alesio tani që është me familje me Alesion e mëparshëm? ( Para se të njihje Kathrine dhe të bëheshe baba?)**

Ka shumë ndryshime pozitive. Mezi pres të jem në shtëpi, ndryshe nga 3 vjet më parë kur nuk e mendoja fare. Tani i shoh gjërat me kujdes duke qenë se kam shumë gjëra të bukura në jetë. Gjërat ndryshojnë për mirë dhe jo për keq.

**Çfarë ka ndryshuar tani në jetën e Alesios? Nga çfarë të është dashur apo do të duhet të heqësh dorë?**

Siç thashë dhe më parë, kam një vajzë si yll dhe pres një vogëlush të vijë në jetë, që për mua është një ndryshim i dhuruar nga Zoti. Të heq dorë? Hmmm. Tani e hedh gurin dhe e fsheh dorën. (Qesh)

Opinioni i Ditës

# 8 rreziqet kryesore të 2018-ës

Edval Zoto

*(Vijon nga faqja e parë)*

... të vendit, duke nisur nga reformimi i sistemit të drejtësisë, hapja e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian e, duke vijuar me jetësimin e programit ambicioz të qeverisjes nga kabineti i dalë nga zgjedhjet e qershorit 2017, program që pritet të mundësojë një rritje ekonomike në nivelin jo më pak se 4% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB).

Ndërkohë, nga një këndvështrim qëllimisht skeptik, e duke vërejtur një sërë faktorësh të brendshëm e të jashtëm, në një skenë tepër dinamike në të cilën jetësohet realiteti shqiptar, mund të evidentohen disa rreziqe, të cilët më shumë se disa të tjerë të mund pengojnë zhvillimin e Shqipërisë përgjatë këtij viti. Këto rreziqe, me shumë gjasa nuk pritet të ndikojnë në atë masë sa të ndryshojnë në mënyrë domethënëse rrugëtimin politiko-ekonomik të vendit, por që me shumë mundësi do ta bëjnë atë më të vështirë, duke krijuar pengesa, vonesa dhe shpërqendrime të ndryshme, sipas karakteristikave të tetë rreziqeve më të mundshme të evidentuara si më poshtë:

1. Skena politike do të vijojë të qëndrojë e radikalizuar, duke e vështirësuar politikëbërjen dhe vonuar vendimmarrjen. Forcat kryesore politike do të vijojnë mosmarrëveshjet e përplasjet publike duke synuar dobësimin e kredibilitetit publik të palëve kundërshtare, si dhe rritjen e radhëve të mbështetësve nëpërmjet afrimit të të pakënaqurve dhe oportunistëve qoftë në radhët e politikës, por dhe të publikut. Fitorja domethënëse në zgjedhjet parlamentare i jep mundësinë Partisë Socialiste të qeverisë e qetë e vetme dhe gjithashtu i jep avantazhin e përzgjedhjes së aleatëve në vazhdimësi. Afrimi, si dhe homogjenizimi politik i këtyre është i pashmangshëm në kushtet e mungesës së alternativave të besueshme opozitare. Nga ana tjetër, forcat opozitare, nëse vijojnë me modelin e të bërit opozitë duke ruajtur një nivel të lartë radikalizimi dhe konfliktualiteti në marrëdhëniet me pozitën, në mungesë të skandaleve konkrete qeveritare, pritet të pësojnë humbje të mbështetjes publike.

2. Zbritja e konfliktualitetit në qeverisjen vendore dhe përgatitja e "betejës" zgjedhore vendore në 2019. Gjatë këtij viti pritet që konfliktualiteti midis forcave politike në pushtet dhe atyre në opozitë të zbresë dhe në nivelin e qeverisjes vendore. Në këtë nivel, konkurrenca politike do të parapërgatitet për zgjedhjet vendore të vitit 2019, të cilat do të diktojnë dhe orientimin apo karakteristikat e veprimtarisë politike të këtyre forcave në 61 bashkitë e vendit. Radikalizimi dhe konfliktualiteti i lartë politik në vend pritet të ndikojë gjithashtu dhe në shkurajimin e investitorëve, por edhe në bllokimin e vonimin e projekteve zhvilluese, sidomos në rajonet me rivalitet të theksuar politik.

3. Rritja e kriminalitetit dhe e akteve kundër rendit publik si pasojë e reformave institucionale. Reformat e nisura në sektorin e drejtësisë, por dhe në ekzekutiv pritet të shkaktojnë pakënaqësi në radhët e personave të inkriminuar, të cilët mund të kundërveprojnë duke ndikuar në sigurinë publike. Jo vetëm procesi i vetingut në gjyqësor, por dhe ai i nisur tashmë në Policinë e Shtetit pritet të nxjerrë nga sistemi një serë individësh të inkriminuar e me lidhje të provuara me kriminalitetin në vend. Këta individë të përjashtuar, e sidomos ish-pjesëtarët e forcave të sigurisë, nga eksperienca të mëparshme është provuar se përfundojnë në shërbim të kriminalitetit si dhe të grupeve kriminale me të cilët kanë bashkëpunuar më parë. Gjithashtu, përjashtimet e mësipërme, në mungesë të strategjive re-integruese në komunitet, mund të shkaktojnë dhe veprime hakmarrëse kundrejt institucioneve shtetërore, të cilat mund të ndikojnë sigurinë publike. Një aspekt tjetër që mund të ndikojë në shkallën e kriminalitetit në vend është dhe formësimi rishtazi i një sërë strukturash me karakter "task-force". Organizime të tilla në brendësi të forcave të sigurisë, sidomos kur kërkohet të funksionojnë me afat të gjatë, shkaktojnë dhe probleme që lidhen me mbivlerësimin e vetë strukturës "task-force" dhe nënvlerësimin e strukturave të zakonshme (qoftë dhe në pikëpamje të menaxhimit të personelit). Gjithashtu, krijimi i një sërë institucionesh të reja në kuadër të Reformës në Drejtësi, ka premisa të ndikojnë në shpërqendrimin e institucioneve ekzistuese të angazhuara në luftën kundër kriminalitetit.

4. Ri-"ballkanizimi" dhe zhvendosja drejt rajoneve jo-tradicionale të hartës së mbjelljes së kanabisit. Pavarësisht angazhimit publik të autoriteteve shtetërore për eliminimin e fenomenit të prodhimit të kanabisit në Shqipëri, angazhimi kriminal në vend ka një "kërkesë", për të përmbushur dhe përpjekja për vijimin e kësaj veprimtarie të paligjshme nuk ka për t'u ndërprerë, ndërkohë që pritet që plantacionet e reja të kanabisit të spostohen drejt rajoneve më pak të kontrollueshme të vendit, ku vështirësia e monitorimit është më e lartë dhe lehtësia e shmangies së forcave të ligjit është më e madhe. Plantacionet e kanabisit pritet të zvogëlohen në përmasa, por duke u përhapur në shumë zona, duke mos përjashtuar dhe përhapjen e plantacioneve në hapësira të mbyllura (sera, kapanone) ndërkohë që pritet gjithashtu që të sofistikohen dhe mënyrat e transportit dhe trafikimit jashtë vendit.

5. Rënia e nivelit të investimeve të huaja si rezultat i përfundimit të projekteve madhore në zhvillim. TAP dhe Statkraft, që kanë qenë motorët e fuqishëm të injektimit të investimeve në vend përgjatë viteve të shkuara, pritet të përfundojnë fazat zhvilluese të investimeve të tyre në Shqipëri në vitin 2018. Bashkë me to pritet të ndalojë dhe fluksi i valutës që futet në vend nga këta aktorë me ndikim mbresëlënës në ekonominë e vendit. Gjetja dhe tërheqja e investitorëve madhorë të jashtëm mbetet një sfidë e madhe për autoritetet shtetërore.

6. Paketa fiskale 2017: Qeveria bën mirë të dijë mirë çfarë ka bërë. Nga të gjitha amendimet fiskale që qeveria ndërmori në fund të vitit që lamë pas, amendimi që tërhoqi më shumë vëmendje, e që ngjalli më shumë shpresë ishte favorizimi me ulje takse, që qeveria u bënte operatorëve ndërkombëtarë të hotelerisë, ose emrave të mëdhenj, si "Sheraton" etj., në përpjekje për të tërhequr investitorë seriozë në këtë sektor. Përkundër çfarë pritej, dhe si një grusht i beftë nën brez për hartuesit e paketës fiskale, erdhi lajmi i tërheqjes së "Sheraton", linjë hotelesh e "Marriot International", nga Shqipëria që në ditën e parë të 2018-es. Pavarësisht se ky largim, siç përflitet, nuk ka lidhje me vështirësitë e lidhura me përballimin e taksave shtetërore, por me mosmarrëveshjet midis investitorëve në rastin konkret, do të ishte mirë që të paktën ky rast të shërbente edhe si mësim për administratën që do të implementojë paketën e re fiskale dhe të menaxhojë favorizimin me po aq rigorozitet sa dhe trajtoi "Marriot International" ruajtjen e brandit të saj, "Sheraton", në raportin me një kompani vendëse.

Përtej amendamenteve fiskale për sektorin e turizmit, amendamenti që do ndikojë më gjerësisht ekonominë vendëse do jetë ai i uljes së pragut të TVSH-së. Për këtë amendament qeveria ka marrë kritika nga aktorë të rëndësishëm në vend, duke përfshirë FMN-në si dhe Dhomën Amerikane të Tregtisë dhe gjithashtu në këtë rast qeveria duhet t'i ketë bërë mirë "hesapet". Mijëra biznese të vogla pritet të përfshihen në këtë skemë dhe pavarësisht se rëndom përmendet se kjo masë do të ulë informalitetin, askush nuk ka mundur të parashikojë shifra konkrete.

Gjithashtu, qeveria i ka dhënë edhe vetvetes të drejtën për të ndryshuar pragun e TVSH-së sipas gjykimit të Këshillit të Ministrave, gjë e cila ndikon negativisht në krijimin e besueshmërisë për tregun, nga ana e investitorëve vendës apo të huaj.

7. Një rend ndërkombëtar pa një "rend" të caktuar, dhe një rajon i stabilizuar, por jo i qetë. Oportunizmi, kryeneçësia dhe mungesa e gatishmërisë për t'i kushtuar vëmendje opinionit dhe interesit të gjerë publik janë karakteristikat që sipas të gjitha gjasave do të karakterizojnë rendin ndërkombëtar në vitin 2018. Tashmë, protagonistë të kësaj lloj sjelljeje delegjitimuese të rendit ndërkombëtar janë jo vetëm liderë lindorë, por edhe perëndimorë. Në

Opinioni i Ditës

# Shfuqizimi i Speciales vë në sprovë raportet e Kosovës me shtetet mike

Arton Konushevci

*(Vijon nga faqja e parë)*

... Speciale, përkatësisht Dhomat e Specializuara, thonë deputetët opozitarë dhe njohës të çështjeve juridike.

Dastid Pallaska, njohës i fushave juridike, tha për Radion Evropa e Lirë se Kosova si në aspektin e brendshëm, po ashtu edhe në atë ndërkombëtar, do t'i ndjejë pasojat në rast se shfuqizohet ligji, të cilin e kishte miratuar vetë Kuvendi i Kosovës.

"Përveç izolimit, i cili vetëm se ekziston në një formë të butë dhe që do të ashpërsohej, unë mendoj se bashkësia ndërkombëtare do të tërheqë gjithë përkrahjen diplomatike, ekonomike e politike për Kosovën, që pikë së pari do të reflektohet në raportet e Kosovës me Serbinë, përkatësisht do ta ndjejmë peshën e vërtet të shtetit serb apo armiqësitë që vijnë nga shteti serb",-tha Pallaska.

Ndërkaq, Vjosa Osmani, kryetare e Komisionit parlamentar për Punë të Jashtme nga Lidhja Demokratike e Kosovës tha për Radion Evropa e Lirë se, nëse arrihet që të shfuqizohet ligji për Specialen, pasojat do të jenë të shumëfishta.



"Në radhë të parë, Kosova do të izolohet në aspektin ndërkombëtar, jo vetëm si shtet, por edhe bartësit e institucioneve do të futen në lista sanksionesh të ndryshme dhe kjo do të ishte shumë e dëmshme në aspektin e imazhit ndërkombëtar të vendit. Po ashtu, edhe shtetet që më se shumti e kanë përkrahur Kosovën qysh nga vitet e '90-ta, pastaj në gjithë procesin e shtetndërtimit, do ta braktisin Kosovën, sa i përket përkrahjes që e kemi pasur deri tani",-tha Osmani.

Deputetja Osmani tha se në rast se ndodh që ligji të shfuqizohet, Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara mund të ndërmarrë nisma për miratimin e ndonjë rezolute të re, në bazë të së cilës, gjykata prapë mund të funksionontë. Ajo thotë se duke u bazuar në deklaratat e zyrtarëve të partive politike në pushtet, kjo nismë nuk ka të ndalur.

"Në asnjë moment nuk mund të përjashtohet mundësia që Këshilli i Sigurimit të OKB-së të marrë masa duke u bazuar në Rezolutën 12 44. Pra, pasojat do të jenë të mëdha e të shumëfishta. Do të jenë edhe politike, edhe të sferave të tjera. Prandaj, mendoj që e tërë nisma për ta shfuqizuar Gjykatën Speciale është e pamatur dhe dëmton Kosovën dhe të gjitha të arriturat që i kemi bërë bashkë me partnerët tanë (ndërkombëtarë), dhe po ashtu e bllokon Kosovën që të bëjë hapa përpara në procesin e shtetndërtimit", -tha Osmani.

Megjithatë, Osmani potencon edhe faktin se Gjykata Speciale nuk mund të shuhet tërësisht pa ndryshime kushtetuese. Kurse, ndryshimet në ligjin për Dhomat e Specializuara, sipas saj, mund të kalojnë me një shumicë të thjeshtë të votave në Kuvend.

Ndërkohë, avokati Dastid Pallaska thekson se dëmi që mund të shkaktohet nga anulimi eventual i Gjykatës Speciale, nuk kufizohet vetëm në përkeqësimin e raporteve të vendit me aleatët, ngase mund të prodhojë edhe tensione të brendshme, duke i pozicionuar forcat politike për dhe kundër UÇK-së dhe luftës së fundit.

Sipas tij, së paku 10 deputetë mund të kërkojnë vlerësim kushtetues të vendimit të Kuvendit pranë Kolegjit Kushtetues të Gjykatës Speciale.

"Janë dy grupe parlamentare që kanë gjasa reale ta dërgojnë një kërkesë të tillë. E para është LDK-ja dhe e dyta është Lista Serbe".

Por, ai thekson edhe faktin se cilado nga këto grupe që do ta bënte një kërkesë të tillë, do të portretizohej si një palë që e urren Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe që është kundër UÇK-së.

"Ky portretizim, normalisht jo i drejtë, do të krijonte ndasi të thella shoqërore, të cilat mund të prodhonin edhe konflikte të brendshme nga trazirat shoqërore, që mund të shkaktoheshin nga një ballafaqim i krahut të paqes me krahun e luftës",- thotë Pallaska.

"Në rast se materializohen këto rrezike nuk do të jemi vetëm vend i izoluar, por vend i izoluar në konflikt të brendshëm",- thekson tutje ai.

Gjykata Speciale ka nxitur debate të ashpra në Kosovë. Një pjesë e spektrit politik e konsideron atë të padrejtë dhe të njëanshme, pasi që do të hetojë vetëm krimet e supozuara të pjesëtarëve të UÇK-së, pjesa tjetër e spektrit që ka mbështetur edhe ndryshimet ligjore e kushtetuese për punën e kësaj gjykate, ka vlerësuar se me gjykimet që priten, nuk atakohet lufta e UÇK-së, por individët.

Mandati i Gjykatës Speciale për krime lufte, përkufizohet kryesisht në hetimet dhe gjykimet e rasteve të pretenduara të krimeve të luftës nga ana e disa ish-pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ndaj pjesëtarëve të komuniteteve pakicë dhe kundërshtarëve, që përfshinë periudhën kohore nga viti 1998 e deri në fund të vitit 2000.

Nisma e deputetëve të Kuvendit ka nxitur reagime të ashpra ndërkombëtare. Shtetet e Kuintit kanë shprehur shqetësimin e thellë me përpjekjet në Kuvendin e Kosovës për shfuqizimin e Gjykatës Speciale për krime lufte, përkatësisht Dhomave të Specializuara.

"Jemi thellësisht të shqetësuara me përpjekjet e vazhdueshme për të zhvlerësuar punën e Dhomave të Specializuara", thuhet në deklaratën e përbashkët.

"Dhomat e Specializuara, në veçanti janë pjesë e rëndësishme e përkushtimit të Kosovës për sundim të ligjit dhe angazhimit të Kosovës për të adresuar krimet e kryera në territorin e saj", -thuhet në deklaratë, e cila u ishte shpërndarë mediave nga ambasada amerikane në Prishtinë.

Aty rikujtohet se vendet e Kuintit kanë qenë prej kohësh miq të vërtetë të Kosovës, përfshirë këtu edhe në kohërat më të vështira.

---

← këtë mjedis, vendet e vogla si Shqipëria, janë më të pambrojtura dhe lehtësisht të ndikueshme qoftë edhe nga interesa afatshkurtra të shteteve të fuqishme. Për më tepër, vendosja në një rajon emblematik të përplasjeve të ndikimeve të shteteve më të fuqishme i krijon Shqipërisë dhe shqiptarëve disa kokëçarje më shumë. Fqinji ynë jugor, megjithëse i kërrusur nga situata ekonomike, qëndron i patundur në bllokimin e çfarëdo iniciative që lidhet me Maqedoninë, fqinjin tjetër tonin, për arsye të emrit kushtetues të tij. Nga ana tjetër, zgjidhja e këtij konflikti, përveç përftimeve për palët e drejtpërdrejta do mundësonte edhe anëtarësimin e Maqedonisë në NATO, duke lehtësuar kështu gjithë aleatët e shumtë në rajon.

Përkundër kësaj ideje krah-rendítëse, përvijohet dhe fuqizimi i marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Rusisë, e sidomos i atyre ushtarake, gjë që si anëtarë të NATO-s na shqetëson, ose më mirë duhet të na shqetësojë, të gjithëve ne aleatëve aktualë në Ballkan.

8. Terrorizmi. Duket sikur rreziku terrorist është i reduktuar për vendin tonë, por në fakt është i pranishëm si rrallë herë më parë. Numri i madh i bashkëqytetarëve, por edhe i bashkëkombësve tanë pjesëmarrës në luftën në mbarim në Siri e Irak krahas grupeve terroriste, sidomos numri i atyre që akoma s'janë kthyer e që pritet të kthehen, numri i të dënuarve për vepra terroriste në Shqipëri e Kosovë, si dhe së fundmi plani i dështuar për të ndërmarrë një sulm terrorist vdekjeprurës në territorin shqiptar në fundin e vitit 2016, tregojnë se rreziku terrorist për vendin tonë mbetet i lartë. Ndërkohë që në vitin 2018 pritet të nisin funksionimin të paktën dy institucione të reja, që do të merren drejtpërdrejt me fenomenin e terrorizmit: Qendra e Ekselencës e NATO-s për Studimin e Fenomenit të Luftëtarëve të Huaj dhe Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm. Ngritja e pritja për nisjen e punës nga ana e këtyre institucioneve me emra të gjatë, por deri më tani pa histori, gjithsesi nuk e lehtëson faktin se Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH), kali historik i betejës i vendit tonë në luftën kundër terrorizmit, ka mësë dy muaj pa një drejtor të emëruar.

---

## HOROSKOPI

### DASHI

Për të mos lënduar familjarët apo miqtë, jeni duke humbur veçoritë e karakterit tuaj. Ka ardhur koha të gjeni një ekuilibër midis vetes dhe të tjerëve. Çojini përpara me vendosmëri idetë tuaja, nëse jeni të bindur për qenësinë e asaj që thoni.

### DEMI

Pavarësisht se dikush është përpjekur që t'ju pengojë, arrini që ta falni e të ecni përpara sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Mund t'i kishit bërë të kuptonte personit përgjegjës se nuk duhej luajtur me zjarrin, por është e kotë të shohësh mbrapa.

### BINJAKET

Do të keni të bëni me një person pak kokëfortë. Nuk do ta keni aspak të lehtë që t'i ndryshoni mendjen, por në fund do të jeni shumë të kënaqur. Do të jeni të aftë të bindni këdo me saktësinë e argumenteve tuaja.

### GAFORJA

Nëse nuk do të përfshiheni nga nxitimi dhe ankthi i performancës suaj, intervista e punës do shkojë mirë dhe do të lini përshtypje të mirë tek të gjithë. Për të mbajtur llogarinë tuaj bankare aktive, përpiquni të shmangni shpenzimet e kota dhe kufizoni shpenzimet në minimumin e domosdoshëm.

### LUANI

Mos e shtoni shqetësimin që vjen nga mungesa e harmonisë hënore dhe mos u angazhoni për të bërë të ecin përpara shumë detyra. Rezultati do të ishte zhgënjyes. Vendosni përparësi, duke u marrë me një të vetme e duke bërë më të mirën sipas mundësive që keni.

### VIRGJERESHA

Edhe pse do të keni një rënie të lehtë të energjisë, për pjesën tjetër të ditës mund të rrini të qetë në shtëpi, pa u druajtur se mund t'ju kërkojë dikush. Por, nëse ka nevojë për ndihmën tuaj, mos e mohoni, edhe pse do të kishit parapëlqyer të rrinit pa bërë gjë.

### PESHORJA

Me Hënën që ju vëzhgon, ndjeshmëria juaj do të rritet jashtë mase. Ndërkaq, bëni kujdes për të mos humbur arsyen thjesht për një gjest. Valë pasioni dhe vështrime shpërfillëse. Përdorini aftësitë tuaja me kujdes, në të kundërt do të ketë probleme.

### AKREPI

Në këtë moment mund të keni më shumë pretendime ndaj kolegëve, por edhe nga vetja, nëse doni të arrini objektivat e vendosura. Përdorini të gjitha mjetet që keni në dispozicion, për të çuar 'anijen në port', ia vlen me të vërtetë barra qiranë.

### SHIGJETARI

Keni zbuluar në personin e dashur një anë, ekzistencën e së cilës e keni shpërfillur? Nuk ka problem, do të shërbejë për ta bërë marrëdhënien tuaj në çift më të plotë. Gjatë kësaj periudhë jeni shumë të shpërqendruar, tregohuni të vëmendshëm, nëse do të angazhoheni në atë që bëni.

### BRICJAPI

Fjalët e bukura dhe vështrimet e ëmbla nuk ju mjaftojnë? Mos kërkoni shumë nga partneri, nëse nuk doni të krijoni tensione që nuk kanë arsye të jenë. Të kënaqeni është e rëndësishme, nëse doni të ndërtoni themelet mbi të cilat të ngrini një raport të qëndrueshëm.

### UJORI

Të ndriçosh të gjitha zonat e errëta që keni gjetur përgjatë rrugës nuk është e lehtë. Është më mirë të përballësh me gjërat me radhë, sesa të mbash shumë kunguj nën një sqetull. Mos i merrni të gjitha gjërat e mirëqena dhe shikoni përtej asaj çka duket në pamje të parë për të mos gabuar.

### PESHQIT

Do të përfitoni nga një çast lodhjeje të një kolegu për të treguar besnikëri dhe përgjegjshmëri, duke fituar kështu pikë në sytë e shefit. Të përveshësh mëngët nuk është problem, aq më tepër nëse e dini që do t'ju shpërblehet bujarisht.

### Sulmuesi firmos për 6 muaj

## Xhevahir Sukaj rikthehet te Vllaznia

Xhevair Sukaj rikthehet te Vllaznia, pasi i dha fund aventurës së tij me Partizanin në Superligë. Sulmuesi, i cili kishte arritur më parë marrëveshjen me klubin e qytetit të tij të lindjes është prezantuar zyrtarisht nga administratori Atrit Gjyrezi. Ndërkohë, në llogarinë zyrtare të Vllaznisë në "Facebook", bëhet e ditur se Xhevair Sukaj ka firmosur kontratën deri në 31 maj të këtij viti, çka do të thotë se ai do të luajë deri në fund të sezonit, ndërsa më pas do të vendosë sërish se çfarë do të bëjë me karrierën e tij. "Rikthehem pas 6 vitesh. E kam ndjekur ekipin. Vllaznia është nga skuadrat më të mira dhe kam çfarë gjej. Shpresoj të bëjmë më të mirën. Kisha mundësi të ikja jashtë, po ashtu kisha kontratën edhe me Partizanin, por duke parë situatën e Vllaznisë, vendosa të vij këtu, gjë kjo ndikuar edhe nga kushtet familjare. Dua t'i shërbej skuadrës së zemrës dhe qytetit tim. Kam qenë kritik me bashkinë para 2 viteve dhe mendoj se më e mira për Vllazninë është të drejtohet nga privati". Menjëherë pas prezantimit, futbollisti do të udhëtojë bashkë me skuadrën drejt Ulqinit, ku do të jetë në dispozicion të trajnerit Ernest Gjoka. Ishte pikërisht tekniku, që paralajmëroi këtë përforcim me shpresën që Sukaj do të ndihmojë Vllazninë në objektivin e saj për të shpëtuar sezonin. Po ashtu, Gjoka pret edhe prurje të reja në skuadër gjatë merkatos së janarit si dhe qartësimin e situatës financiare nga ana e klubit shkodran, që deri tani ka ndikuar negativisht edhe në fushën e lojës.

Jeton Selimi

### Pak përpara nisjes për në Antalia, u quajt i përfunduar transferimi i bujshëm, por jo...

# Abzaj-Bregu te Skënderbeu kthehet në 'telenovelë turke'

## *Sulmuesi pohon kalimin, presidenti Tavo përgënjeshtron*

Në mëngjes Abazaj dhe Bregu ikin në Korçë, pasdite kthehen prapë në Gjirokastër! Duket si një lojë fjalësh, por kjo është në të vërtetë e gjithë situata e krijuar nga deklarata kontraverse të protagonistëve në media të ndryshme. Fillimisht lojtari Kristal Abazaj deklaroi se ka firmosur për Skënderbeun dhe do t'i bashkohet ekipit korçar në qershor, sikundër edhe shoku i tij i repartit te Luftëtari, Dejvi Bregu, ndërsa disa orë më pas ishte presidenti Grigor Tavo që mohoi gjithçka me një prononcim të shkurtër.

**ABAZAJ POHON**

Kristal Abazajn pranon gjithçka duke treguar edhe detajet e kontratës sa firmosur me klubin korçar: "Po, jam një futbollist i Skënderbeut. Kemi mbyllur gjithçka dhe bëhet fjalë për një kontratë dyvjeçare. Di që Skënderbeu ka paguar një shumë të mirë për mua, por nuk di shifrat e sakta. Klubet kanë rënë dakord që unë të vazhdoj të luaj për Luftëtarin deri në fund të sezonit, meqenëse ky ekip ka nevojë. Por, pagesa ime do të bëhet nga Skënderbeu", - sqaron fillimisht sulmuesi i krahut të djathtë. Futbollisti 21-vjeçar shprehet më tej se ka pasur oferta edhe nga jashtë

vendit, madje edhe nga skuadra të njohura, por vendosi të kalojë te Skënderbeu, duke e konsideruar si shansin e artë të karrierës së tij: "Me thënë të drejtën, kam pasur edhe oferta nga jashtë vendit. Dhe bëhet fjalë për skuadra të mira, me emër, por arritëm në përfundimin se Skënderbeu është zgjedhja më e mirë për mua. Skënderbeu luan rregullisht në Europë dhe është një vitrinë e mirë për çdo lojtar, që duke luajtur në kompeticionet europiane, mund të vëzhgohet nga skuadrat e huaja dhe më pas të luajë në skuadra më të mira. Jam i lumtur për këtë vendim dhe jam i bindur se kam bërë zgjedhjen më të mirë. Kam kaluar në një ekip vërtet europian. Tani dua të ndihmoj Luftëtarin për pjesën e mbetur të sezonit", - ka theksuar Abazaj.

**TAVO MOHON**

Komplikohet situata për transferimin e Kristal Abazajt te Skënderbeu. Fakti që asnjë nga klubet nuk e ka bërë zyrtar deri më tani këtë kalim të bujshëm, gjithçka është shoqëruar me dritëhije. Mirëpo, deklarata e vetë Abazajt gjatë ditës së djeshme duket sikur i vuri vulën faktit që ai ka firmosur me korçarët. Gjithsesi, nuk është kështu sipas presidentit të Luftëtarit, Grigor Tavo, i cili për "Panorama Sport", deklaroi: "Nuk kemi asnjë marrëveshje me Skënderbeun. Bregu dhe Abazaj do të jenë të Luftëtarit deri në qershor të vitit 2018. Më pas e di vetëm Zoti i madh se çfarë do të sjellë për këta lojtarë, ose më saktë se ku do t'i shesim. Pavarësisht se çfarë flitet, nuk ka asgjë zyrtare".

**DETAJET QË PËRFLITEN NË KONTRATË:**

- Duke qenë se ka firmosur me Skënderbeun, për 6 muajt e mbetur të kampionatit do jetë klubi korçar që do e paguajë rrogën e Kristal Abazajt, ndonëse do luajë me Luftëtarin.
- Klubi gjirokastrit do përfitojë një përqindje të konsiderueshme nga kartoni i Abazajt, në rast të shitjes së tij jashtë Shqipërisë.
- Skënderbeu do tregojë gatishmëri për të huazuar element të rinj te Luftëtari, të cilët mund të mos jenë në planet e trajnerit Ilir Daja.
- Futbollisti Kristal Abazaj do përfitojë një pagë prej 5 mijë eurosh në muaj.

### KAMPIONËT

## Kukësi në lëvizje, vjen një sulmues nga Trinidad & Tobago

Kukësi ka nisur me pro vat e futbollistëve dhe në Turqi është bashkuar me verilindorët një sulmues anësor nga Trinidad & Tobago, sikurse edhe njofton klubi kampion në fuqi. "Sot (dje) në seancën e dytë stërvitore të ekipit të Kukësit, vëmendja është përqendruar në përgatitjen atletike të lojtarëve, por edhe të veprimeve me topin. Grupit të lojtarëve i është bashkuar dhe futbollisti nga Trinidad & Tobago, Nicholas Lee Dillon. 20-vjeçari do të jetë në provë dhe po vëzhgohet me imtësi nga trajneri Pakult", thuhet ndër të tjera në njoftimin e Kukësit. Deri më tani është zyrtarizuar afrimi i Donjet Shkodrës, ndërkohë që ka nënshkruar edhe Maldin Ymeraj, por klubi kuksian ende nuk e ka bërë një njoftim për këtë. Sa i takon Nicholas Lee Dillon, ai ka luajtur në kampionatin e vendit të tij me Rangers dhe Central FC, ndërkohë që së fundmi i është bashkuar Patro Eisden në Belgjikë. 20-vjeçari luan edhe me Trinidad & Tobago U20.

### KE MBLIDHET SOT

## Federata zyrtarizon ditën e Asamblesë Zgjedhore

Zgjedhjet për President të FSHF-së do të jenë tema kryesore e mbledhjes së parë të vitit për Komitetin Ekzekutiv të institucionit që drejton futbollin në vendin tonë. FSHF ka bërë të ditur nëpërmjet një njoftimi se nesër do të caktohet data e Asamblesë së Përgjithshme Zgjedhore, që hap rrugën për caktimin e kreut të këtij institucioni. Në mbledhjen e sotme, anëtarët e Komitetit Ekzekutiv do të përcaktojnë datën si dhe vendin ku do të zhvillohet kjo Asamble, e cila pritet që të zhvillohet para fundit të muajit shkurt. "Ditën e shtunë, datë 6 janar (nesër) në orën 11.00 do të zhvil-

lohet mbledhja e radhës e Komitetit Ekzekutiv të FSHF-së, e para për vitin 2018. Kjo mbledhje në rend të ditës do të ketë përcaktimin e datës dhe vendit, të zhvillimit të punimeve të Asamblesë së Përgjithshme Zgjedhore për këtë vit, si dhe rendin e ditës së punimeve të kësaj asambleje, e cila këtë radhë, përpos pikave të tjera do të zgjedhë edhe forumet e reja drejtuese të futbollit shqiptar për 4 vitet e ardhshme", lexohet ndër të tjera në njoftimin e FSHF-së.

### DURRSAKËT

## Teuta sjell ish-mbrojtësin e Bate Borisovit

Teuta ka zyrtarizuar goditjen e parë në merkato, pas emërimit në krye të pankinës së trajnerit Stavri Nica. "Djemtë e Detit" kanë firmosur me mbrojtësin maqedonas Bojan Gjorgievski. Futbollisti zhvilloi dje stërvitjen e parë me klubin, teksa ka firmosur kontratë 1-vjeçare. Pozicioni i tij është mbrojtësi i djathë, ndërsa në të kaluarën ka mbajtura veshur fanellën e Vardarit, BATE Borisov, Metalurg Shkup, Pobeda dhe së fundmi Macva Sabaç. Gjerogievski është 25 vjeç dhe në sezonin 2012-2013 ka qenë pjesë e kombëtares U21 të Maqedonisë, ku në 7 takime ka realizuar edhe një gol.

# Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Steiger aktor.
4. Mbetet në fund.
6. Ustinov i kinemasë.
11. Janë në modë.
12. Nuk e shqyen Danielin.
15. Një as i Milan.
16. Çobani aktore e jona.
18. I dyti në kapitull.
19. Dy asa në dorë.
21. Që njeriu i parë që u dënua padrejtësisht.
23. Croft e Angelina Jolie.
24. Një që mbahet për mondan.
25. Para De Janeiro-s.
27. Gjysmë tandem.
29. Kap ndryshe.
30. Gjysmë tatimi.
31. Union Stutendor Operativ.
33. Wallach aktor.
35. Pak spiunazh.
37. Ishin hipokritët e Jezu Krishtit.
38. Ai dhe ajo.
40. Një Madame e Maupassant.
41. Kështu thirrej Ernesto Guevara.
42. Fund ditari.
43. Pije piratesh.
45. Kush e thotë refuzon.
46. Të parat në sondazh.
47. Një makinë franceze.
48. Fillojnë stafetën.
49. Nisin nga fillimi.
50. Qan te Turandot.
51. Fundi i një samurai.
52. Umberto që shkroi Lavjerësi i Foucault.
53. Dalë në krye.

VERTIKAL

1. Ajo e tretë u quajt Moska.
2. Në hyrje të odës.
3. Me mea për të penduarin.
4. Para... Gay në aeroplanin që hodhi bombën atomike në Hiroshima.
5. Jepet për hartim.
7. Lindi edhe Cerberin.
8. Mbyllin pora.
9. Gjysma e ekipit.
10. N jë inkursion me mig.
12. Fillojnë lehtë.
13. Eshtë tretës me zorrë.
14. Pak tematike.
17. Që mbreti jetëgjatë i Pilos.
20. Eshte ndalim me pranga.
22. Shkroi Këngëtarja tullace.
23. Eshtë pikë vaji.
26. Ndajnë shtetet.
28. Kush nuk ka... s'është njoftuar.
32. Poetja e Lesbos.
34. Kështu shprehet komisari Rex.
36. Fillojnë panikun.
38. Një liqen i kripur.
39. Inva soprano.
43. Inicialet e Altman
44. Një fjalë për sipër.
46. Të parat në stadium.
47. Fillojnë turnin.
48. Në hyrje të sokakut.
49. Fillojnë nazet

# Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL

3. Një pune... paguhet.
6. Para Zeppelin në grupin e famshëm.
8. Vincenzo, bomber te Roma.
12. Kufijtë e pritjes.
13. Një Arthur i Edgar Allan Poe.
16. Demek s'ka kufij.
18. Që filozofi i shkollës eleatike.
19. Nino, kompozitor i famshëm italian.
21. Eshtë ai që ka ngrityr krye.
23. Finlanda e... finlandezëve.
25. Mbledh baskët separatistë.
26. Inicialet e Prost.
28. Shkroi Cocktail party.
29. Titulli i Alex ferguson.
30. Stile pa kufij.
32. Ishin greket që nuk vinin kurrë.
35. Unë dhe ti.
36. Hoxha që qe arbitër.
38. Eshtë provë zjarri.
39. Majtas në fund.
41. Agjenci Ajrore Tiranë.
42. Eshtë partia e Ariel Sharon.
43. Një mund të jetë çiklistik.
45. Të parat në sondazh.
46. E famshme ajo e psherëtimave.
47. Qendër ditore.
48. Një Baba përrallor.
49. Mund të jetë proteste.
50. Në fund të fundit.

VERTIKAL

1. Camille, indulgjenti që krijoi Vieux Cordelier.
2. Në krye të solistëve.
3. Janë poetë si Ungaretti.
4. Ylli më i shndritshëm i Demit.
5. Janë kopjet si delja Dolly.
7. Një pjesë e dimensioneve.
8. Fillojnë muzikën.
9. Parafjala e prejardhjes.
10. Fernando, bomber i Liverpool.
11. Bisha aktore.
12. Ishin ushtarë të Kserksit.
14. Partia Demokratike.
15. Cepat e një ylli.
17. Ylli i baletit.
20. Pak amoralitet.
22. Mbushin enë pa fund në ferrin dantesk.
24. Italia në Internet.
27. Përhapet me frikë.
31. Mund të jetë françeskan.
33. Dehin pa kufij.
34. Eshtë lënda për... rafte.
37. Gjysmë sahati.
39. Tatum që qe pianist.
40. Lloj papagalli.
42. Një pikë vaji.
44. Artikull spanjol.
45. Në krye të socialistëve.



# Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

# SUDOK

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 9 | | 8 | | | 5 | | |
| 3 | | | 5 | 1 | 9 | | | 6 |
| 6 | 2 | | 4 | | | | 8 | 9 |
| | | 1 | | | 8 | | 9 | |
| 7 | 4 | | | | | | 3 | 1 |
| | 5 | | 3 | | | 2 | | |
| 5 | 6 | | | | 2 | | 7 | 4 |
| 4 | | | 9 | 7 | 3 | | | 8 |
| | | 3 | | | 4 | | 1 | |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | 8 | 1 | 3 | 2 | 9 | 5 | 4 | 7 |
| 4 | 2 | 3 | 5 | 1 | 7 | 6 | 8 | 9 |
| 5 | 9 | 7 | 6 | 4 | 8 | 2 | 3 | 1 |
| 2 | 7 | 8 | 4 | 6 | 1 | 3 | 9 | 5 |
| 3 | 5 | 4 | 8 | 9 | 2 | 7 | 1 | 6 |
| 1 | 6 | 9 | 7 | 3 | 5 | 8 | 2 | 4 |
| 9 | 1 | 6 | 2 | 5 | 3 | 4 | 7 | 8 |
| 8 | 3 | 5 | 1 | 7 | 4 | 9 | 6 | 2 |
| 7 | 4 | 2 | 9 | 8 | 6 | 1 | 5 | 3 |

# Argëtim filozofik

DA VINÇI

- Nuk ka rëndësi kush të zhgënjeu, apo kush të rrëzoi, rëndësi ka kush të bëri të buzëqeshësh sërish.
- Mos ndiq askënd... një person që të vlerëson ecën përkrah teje.
- Në jetën tuaj do të jenë disa njerëz, që në një moment të caktuar do të bëhen shokët tuaj, dhe do të jenë disa shokë që në një moment të caktuar do të jenë thjesht shokë....

# KRIPTOSKEME



# KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| H | I | J | A | ■ | ■ | K | S | ■ | S | T | O | L |
| A | N | E | T | ■ | D | A | F | ■ | H | ■ | L | T |
| B | A | T | ■ | H | E | R | E | T | I | K | E | ■ |
| I | T | ■ | H | O | N | O | R | A | R | I | ■ | T |
| T | ■ | K | A | P | I | T | A | L | I | S | T | E |
| O | A | L | ■ | K | R | A | ■ | ■ | T | ■ | R | L |
| R | E | A | ■ | I | O | ■ | S | J | I | ■ | A | E |
| E | ■ | S | ■ | N | ■ | A | T | O | ■ | T | I | F |
| ■ | M | I | S | S | ■ | P | O | E | T | ■ | N | O |
| N | I | K | I | ■ | M | ■ | L | ■ | A | M | E | N |
| A | N | E | S | T | E | Z | I | S | T | ■ | R | A |
| T | A | ■ | ■ | B | A | R | A | K | A | ■ | I | T |

# Argëtim filozofik



PËRGJIGJJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALEKRYQI (1)

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ■ | L | U | I | S | A | ■ | K | O | H | A | ■ | A | D |
| P | O | R | T | A | ■ | F | A | T | A | L | E | ■ | E |
| E | S | ■ | A | ■ | D | L | P | ■ | R | ■ | ■ | S | S |
| N | A | T | ■ | P | E | L | I | K | A | N | I | ■ | H |
| E | L | ■ | S | A | B | O | T | I | M | E | T | ■ | T |
| L | A | K | O | N | I | K | E | T | ■ | V | ■ | T | I |
| ■ | M | O | N | O | T | O | N | ■ | V | E | T | E | M |
| B | O | L | E | R | O | ■ | I | B | E | R | I | K | E |
| ■ | S | I | T | A | R | ■ | ■ | R | R | I | P | A | T |
| P | ■ | B | I | M | E | S | I | A | ■ | A | T | ■ | A |
| I | K | E | ■ | A | T | A | ■ | V | A | ■ | A | D | ■ |
| N | A | T | A | ■ | ■ | M | I | A | ■ | A | P | E | L |

FJALEKRYQI (2)

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| R | O | W | A | N | ■ | B | A | K | A | L | L | I | ■ |
| A | B | E | L | ■ | P | ■ | N | A | T | A | ■ | ■ | R |
| S | O | ■ | E | P | I | T | E | T | ■ | T | R | I | O |
| A | R | A | T | ■ | R | ■ | T | A | T | ■ | T | O | M |
| ■ | R | M | ■ | N | O | T | A | R | E | T | ■ | N | A |
| K | I | ■ | ■ | A | M | E | R | I | K | A | N | E | ■ |
| E | ■ | H | ■ | P | A | M | ■ | ■ | A | ■ | D | S | H |
| ■ | K | O | L | O | N | A | ■ | K | T | ■ | E | C | E |
| T | U | N | E | L | E | T | ■ | R | ■ | E | R | O | S |
| E | R | ■ | A | I | T | ■ | K | E | S | T | I | ■ | A |
| T | A | T | ■ | ■ | ■ | ■ | S | A | R | A | H | ■ | P |
| E | T | J | A | ■ | ■ | K | A | T | E | T | E | ■ | T | I |

# Thënie të mençura

- Mos kini frikë të ndërmerrni një hap të madh nëse është e nevojshme. Nuk mund ta kaloni humnerën me dy hapa të vegjël.
(Dejvid Llojd Xhorxh)
- Ka diferencë të madhe midis pëlqimit dhe dashurisë.. Nëse të pëlqen një lule e këput menjëherë, ndërsa kur e do e 'ujit' dhe përkujdesesh për të gjithmonë.. Populli
- Fëmijet gjejnë gjithçkanë në asgjë, kurse të rriturit asgjenë në gjithçka! (Giacomo Leopardi)-
Miku më i madh i së vërtetës është koha, më i madhi armik

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!

GSH
www.gsh.al

Tashmë edhe lundroni!